

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7327 E enjte 19 Tetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Piramida Maslow, e njohur si piramida e nevojave, është përdorur gjerësisht në fushat e psikologjisë, sociologjisë, por pothuajse asnjëherë ..
Vijon në faqen 20

Nga SORINA KOTI
Piramida Maslow e qeverisë



Opinion i Ditës

Kur isha në vendlindjen time, Portugal dhe më vonë në vende të tjera ku kam pasur kënaqësinë të punoj si Meksikë, Brazil, Egjipt, Emiratet ...
Vijon në faqen 21

Nga JOSE PINTO
Nënë Tereza më ndihmoi të gjej Shqipërinë dhe parajsën



Dokumentet që duhen dorëzuar brenda 3 muajve
Lista e fundit për ish-të përndjekurit, 1000 personat që marrin këstin e parë

Ministria e Financave: Këto emra janë përfutës për herë të parë. Fëmijët dhe nipërit, dosjet për t'u plotësuar
Nga ORNELA MANJANI
Ministria e Financave ka publikuar listën e kategorisë jo parësore në radhët e ish-të përndjekurve politikë që mund të trajtohen me dëmshpërblim, por që sipas këtij dikasteri duhet të sjellin dokumentet ...
Në faqet 7-9

KAPEN 10 TONE DROGE NE VLORE, TE MIKU I HABILAJVE. HETIM KUSHERINJVE TE TAHIRIT

PERGJIMET, HABILAJ: AI TE RADARET ESHTË NJERIU IM

Moisiu: Mos u shqetësoni, policia është me ne. S'jemi të pagabueshëm, kemi dhe ne dru të shtrembër. Basha dhe Kryemadhi bashkojnë opozitën



(Në foto) Moisi Habitaj dhe Florian Habitaj



AKSIONI
Seks në këmbim të kokainës, në pranga pesë shqiptarë në Itali
Në faqen 10

ÇFARË THONE SERBET
Njëshi i stilit bardhekuq nuk i druhet Partizanit të Beogradit: Jemi rritur nga ndeshjet
Në faqen 22

IN MEMORIUM
Zyhi Dervishi: Personaliteti më i arrirë i dijetarit që na mungon
Në faqen 16

LISTA E PERDITËSUAR
Pronarët në Shkodër, kush është kompensuar e statusi i pronës
Në faqen 17-19

INTERVISTA



Klodi Leka: Beteja jonë kundër ligjit të arsimit të lartë, ku nuk përputhemi
Në faqen 11

Sipas ligjit në fuqi për kompensim, pagesat do të kryhen sipas rendit kronologjik

Kompensimi i pronave, 500 mln më pak këtë vit

Fondi special parashikohet të jetë në 1.5 miliardë lekë

Nga ORNELA MANJANI
Ministria e Financave po jep "dorën e fundit" projektbuxhetit për vitin 2018. Qeveria pret të realizojë të ardhura në masën 200 milionë euro më shumë se në 2017 dhe rreth 21 milionë euro prej tyre do të vijnë nga



taksa mbi pronën. Një zë i rëndësishëm në buxhet është kompensimi i pronave. Fondi special parashikohet të jetë në 1.5 miliardë lekë, apo 500 milionë lekë më pak se në 2017-ën për kompensimin e pronarëve. Sipas ligjit në fuqi për kompensimin...
Në faqen 6

DOSJA "HABILAJ" PERGJIMET

"Gjyqtarë e prokurorë të korruptuar liruan trafikantë"

Xhafaj: Është çështje e drejtësisë italiane. Kur flet drejtësia, nuk ka pse flet ministri

Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj, reagoi dje për herë të parë për dosjen hetimore për vëllezërit Habilaj, ku nga përgjimet është përfshirë edhe paraardhësi i tij, Saimir Tahiri. Sipas Xhafajt, nuk është koha për të folur, përderisa çështja është ende nën hetim nga pala italiane. "Është një çështje që nuk i përket Policisë së Shtetit. Është një çështje që i përket drejtësisë dhe është iniciuar dhe vazhdohet nga drejtësia italiane. Në këtë rast flet drejtësia, këto janë çështje që i përketin drejtësisë, nuk



Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj

ka pse flet ministria dhe ministri", tha Xhafaj. Këtë reagim, ministri i Brendshëm e bëri pas një konference për trafikimin e qenieve

njerëzore, ku ai akuzoi edhe klasën politike se flet për trafikun dhe akuzon pa fakte, pa thelb dhe me fjalë boshe dhe se gjithçka sipas

ministrit të Brendshëm, bëhet për përfitim politik. "Të gjithë flasim për trafikun e trafikantët, por harrojmë të ngremë zërin e kërkojmë llogari për njerëzit e drejtësisë, për gjyqtarët dhe prokurorët e korruptuar, që në vite kanë ridënuar apo rrviruar viktimat për t'u shpëtuar burgun llojlloj trafikantëve, që sot shëtisin lirshëm, pasi kanë fituar imunitetin prej drejtësisë së korruptuar", theksoi ministri Xhafaj.



Të arrestuarit në Itali

Moisi dhe Florian Habilaj hetohen si zotërues të 23 tonëve kanabis të bllokuara në Vlorë

Krimet e Rënda nisin hetimin pasuror të vëllezërve Habilaj

Dyshime për pasuri të krijuar nga droga

KAPEN 10 TONË DROGË

Në Babicë kapen 10 ton drogë të klanit Rama - Tahiri! sb qytetari dixhital denoncon!
"Mirëmbërma doktor, në Babicë e vogël sapo është kapur rreth 10 tonë drogë në shtëpinë e Armand Koçerit, mik i Habilajve. Vila e personit e ruajtur me kamera dhe sistem sigurie" -shkruan ish-kryeministri Sali Berisha në "fb".
Burime të sigurta nga Prokuroria e Krimeve të Rënda konfirmuan lajmin për "Gazeta Shqiptare" se hetimi ka nisur një vit më parë prej tyre. Mësohet se policia është njoftuar për të ndërhyrë në momentin e fundit që do të kryhej operacioni, pasi hetuesit kishin dyshime se mund të dekonspirohej operacioni.

shpallën në kërkim dy të tjerë, mes tyre edhe punonjësi i policisë në vendin tonë. Mësohet se hetues të Krimeve të Rënda kanë kontaktuar me homologët italianë dhe se janë në pritje të letër-porositve dhe dosjes së plotë të hetuar nga Antimafia. Por, burime sqaruan se bashkëpunimi mes tyre kishte filluar që në verën e vitit të shkuar, me sekuestrimin e kanabisit në parcelat mes fshatrave Treblovë e Vezhdanisht të Vlorës.

Xhensila Kodra

Kur kanë kaluar vetëm 3 ditë nga arrestimi në Itali i 39-vjeçarit Moisi Habilaj, Prokuroria për Krimet e Rënda ka nisur hetim pasuror ndaj vëllezërve dhe disa prej familjarëve të tij. Burime pranë organit të akuzës bënë me dije se hetimi ndaj tyre ka nisur në kuadër të ligjit Antimafia, për shkak se kanë dyshime se pasuria e tyre mund të jetë përfituar nga aktiviteti kriminal brenda apo edhe jashtë vendit tonë. "Dyshohet se kjo familje ka prona të shumta të paluajtshme dhe llogari bankare të krijuara nga aktiviteti kriminal i trafikut të drogës", thanë burimet. Ndërkaq, po të njëjtat burime sqaruan se vëllezërit Habilaj janë nën hetim nga prokuroria që prej vitit të shkuar. Hetimi nis pas bllokimit të një sasie prej rreth 23 tonë kanabis në Treblovë e Vezhdanisht të Vlorës, në të cilin është përfshirë edhe Antimafia e Leçes. Kjo dosje është hetuar nga prokurorët e Krimeve të Rënda, ku një javë më parë dosja në ngarkim të të arrestuarve u dërgua për gjykim. Pjesë e kësaj dosjeje është edhe një oficer policie, tashmë i shpallur në kërkim. Zotërues të këtyre parcelave mes fshatrave Treblovë e Vezhdanisht (parcela të asgjësuara verën e 2016) dyshohen të kenë qenë vëllezërit Moisi dhe Florian Habilaj. Por, Krimet e Rënda e kanë veçuar dosjen e Habilajve nga grupi tjetër i paratit tashmë në gjykatë.



Moisi Habilaj

Hetuesit tashmë janë duke punuar për zbrëhtimin e mënyrës se si funksiononte kjo organizatë kriminale e kultivimit dhe trafikimit të lëndës narkotike kanabis sativa, e cila është nga më të sofistikuarat që ka hetuar ndonjëherë Prokuroria sh-

BASHKIMI I DOSJEVE

Prokuroria e Katanasias i nisi hetimet në vitin 2013 dhe iu deshën 4 vjet për të dokumentuar veprimtarinë kriminale, që kryhej nga vëllezërit Habilaj. Në dosjen ku bëjnë pjesë



Florian Habilaj

përgjimet mes tyre, por edhe mes pjesëtarëve të tjerë të këtij grupi kriminal, përmendet në të paktën dy raste edhe emri i ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahirit. Ky i fundit ka pranuar se Habilajt janë kushërinjtë e tij të 10-të, por në përgjime evidentehej fak-

ti se Moisi Habilaj i shprehej mikut të tij, Sabaudinit, se 30 mijë euro duhej t'ia çonte Saimirit. Lidhur me këto fakte, tashmë pritet që edhe dosja në të cilën përmendet ish-ministri Tahiri të bashkohet me dosjen ku u arrestuan 7 persona dhe u



DOSJA

Dosja hetimore e autoriteteve italiane me përgjimet e bandës së Habilajve është një material voluminoz me 416 faqe. Në përgjime përmenden emra trafikantësh, njerëz me pushtet në Shqipëri, data me hyrje-dalje nga Shqipëria në Itali dhe anasjelltas, si dhe porositi që ata kryenin për dorëzimin e lëndës narkotike.



TË HETUARIT

Të hetuarit e kësaj dosjeje janë Moisi Habilaj, Maridian Sulaj, Fatmir Minaj, Nezar Seiti, Armando Sulaj, Tigrans Mezuraj, Sabaudin Çelaj, Florian Habilaj si dhe shtetasit italianë të arrestuar, Antonio Riela, Vincenco Spampinato, Angelo Busaca, Gianluca Passavanti. Hetimi ka nisur nga Gjykata e Katanias në tetor të vitit 2013.



YLLI BAKA

Në përgjimet ambientale mes Maridian Sulaj e Mariglen Alimuçaj përmendet edhe emri i këngëtarit të njohur shqiptar, Ylli Baka. Në bisedën mes tyre thuhet se ai është përdorues droge, si gjithë të tjerët. Ndërsa në një reagim për "Newsbomb.al", Baka tha se Habilajt i ka fansa, si shumë të tjerë. "Kam qenë edhe në dasmën e vëllait të vogël të tyre", tha Baka.



MEDIAT ITALIANE

Në maj 2016, "Corriere Della Sera" i kushtoi një artikull të gjatë baronit shqiptar të drogës, Klement Balliit. Në artikull fitej për një lidhje mes grupit të Habilajve me rrjetin e Klement Balliit. Sipas mediave italiane, Habilajt konsiderohen edhe si ndërmjetësit e lidhjes së Balliit me ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri.



PËRGJIMET/ "Shko vetëm drejt, më telefonoi polici që më shpjegoi". Ja nofkat që përdornin trafikantët

"Na informon njeriu im në sallën e radarëve"

Moisi Habilaj: Mos u shqetësoni, këtu policia është me ne

Xhensila Kodra

Në përgjimet e kryera nga autoritetet italiane për vëllezërit Habilaj dhe personat e tjerë të përfshirë në trafikun e drogës, fakte të reja kanë dalë në dritë. Në dosjen voluminoze me 416 faqe thuhet se banda e drogës kishte mbështetjen e policëve shqiptarë. Në bisedat e kryera mes trafikantëve, Moisi Habilaj pohon se shumë policë janë bashkëpunorë të tyre dhe se ka informatorë edhe në sallën e kontrollit (radarëve) të bregdetit. Të hetuarit e kësaj dosjeje janë përgjuar edhe gjatë veprimtarisë që ata kryenin në Shqipëri. Bisedat mes anëtarëve të grupit që trafikonte drogë nga Shqipëria drejt Italisë, implikojnë edhe policinë e vendit tonë, e deri te zyrtarët e sallës së kontrollit, ku njerëz të veshur me uniformë kanë qenë në shërbim të trafikantëve, duke ndihmuar këta me anë të informacioneve që u jepnin. Nga përgjimet del se ata u jepnin informacion që të kalonin drogën pa u shqetësuar. Një nga përgjimet lidhet me bisedën që është bërë mes Moisi Habilaj dhe trafikantëve italianë Rosario Giuliano dhe Xhuzepë Greco, të cilët me peshkarexhën "Fatima" më datë 6 maj 2015 kishin mbërritur në brigjet e Porto Palermos për t'u ngarkuar me drogë. Në përgjime, Moisi Habilaj degohej teksa pohon se nuk duhet të shqetësohen se policët janë me ta,

por gjithësesi ai shton se janë përgatitur edhe për ndonjë të papritur. Po ashtu, në bisedat me ta, Habilaj pranon se ka një mik në sallën e kontrollit, i cili, siç shprehet ai "sheh çdo gjë, madje edhe peshqit në det". Me këtë gjë, ai përfuron pikërisht faktin se ky njeri kishte konstatuar se peshkarexha kishte hyrë në ujërat territoriale greke. Në bisedat e përgjuara bie në sy fakti që flitet për shumë njerëz të njohur në radhët e policisë, por edhe për frikën që trafikantët kishin nga ndonjë tradhtar, siç shprehen ata në bisedat e tyre. Ndërkaq, duke iu referuar dosjes së prokurorisë së Katanias, pjesëtarët e kësaj bande përdornin nofka të ndryshme mes njëri-tjetrit. Vlonjati Florian Habilaj thirrte me nofken "Lolo". Miridian Sulaj thirrte me nofken "Varrri". Fatmir Minaj, personat e përfshirë në trafik i drejtohehin me nofken "Çaku". Kurse nofka që përdorte Sabaudin Çelaj ishte me emrin "Daja", por në dosje thuhet se ai kishte dhe një emërtim tjetër i njohur si "Sabi". Ajo që bie në sy është emërtimi i një personi tjetër i njohur si "Vetlla". Këtë emërtim e mbante italiani, Salvatore Marleta.

MOISI HABILAJ ME TRAFIKANTËT ITALIANË

M: Meqenëse duhet të nisësh në 4 sepse të tjerët dalin në 4 e gjysëm... Ti dil në 4, sepse nuk i dihet kurrë. Furgoni është mbushur... po pret vetëm një sinjal. Kurrë

M: noi che cosa...
T: non capisco perché c'è la sala... come si dice? ... la sala è nell'altra parte nella capitale... dove ci sono i giudici... e mi vuole tutto... perché gli ha chiesto "chi è questo nave"? ... e lui ha detto "che nave"? ... (inc.) ... "ma come mai che è entrato un miglio nelle acque territoriali greche"?
M: non mi questa nave... questo psichereccio... che è entrato un miglio... nelle acque territoriali greche?... perché lui ha detto "il passato nelle acque territoriali della Grecia" ... e non lo so che legge gli ha detto... che cosa se ne fa? Rosario chiede a Moisi il passagio che devono fare al ritorno.
M: tu devi prendere ora da qua... devi uscire... a destra... verso... diciamo... esce qui... come siamo... come siamo arrivati... però non può più a destra?
M: sì... più a destra... la grande isola in devi passare dall'altra parte
R: così?
M: bravo... no come sei venuto
R: la sono venuto così... (inc.)
M: perché lei si ha detto "devi passare dall'isola grande... sono tre isole piccole... ce n'è una più grande"
R: italiano
M: l'ultimo da quella parte... poi
R: poi faccio così... e poi faccio il giro così
M: bravo... per andare
R: per andare
M: devi venire di nuovo così... come devi partire ora...
T: come dall'isola... 3 miglia...
M: uomini il tragitto da fare si rimpio e fa presente che deve uscire... e allora i due pescatori parlano tra di loro.
Un mezzo di trasporto che si ferma vicino al psichereccio.
Subito dopo, si sente Moisi che, con tono alterato, si rivolge (in lingua straniera) ad un uomo

Faksimile e dosjes ku Moisiu flitet për të njohurit e tij në sallën e radarëve

nuk i dihet. Furnizohemi fillimisht me naftë dhe jemi në rregull nëse vjen ndokush. Sepse do jemi të ngarkuar 2 orë me m... sipër më kuptove? S'i dihet se kush drejton mund të vijë, kush vjen apo shkon. Ne jemi të kompletuar, por mund të dalë ndonjë bastard.

M: E për furgonin e policisë që kaloi pak më parë?
R: Atë me dritë të bardhë?
M: Po, shkoj andej apo këtej?
R: Andej, ajo që të thashë unë. Andej është makina. Ata ishin tanët?
M: Si?
R: Ishin tanët?
M: Janë të gjithë tanët. Por ka ndonjë brinjat, nuk i dihet. Nuk e dimë të gjithë këtë, ndaj të them që duhet të presim dy orë, me ngarkesën sipër 5 minuta,

bam-bam dhe shkon. Këtu jam unë, jemi 6 apo 7 persona. Jemi në katër vëllezërit, jemi sonte këtu. Djali që doli pak më parë, (i referohet këtu Sabaudin Çelës), doli një muaj më parë nga arresti i shtëpisë. Shkova e mora dhe e solla këtu. Dhe ata dy nipat e mi. Nuk ka njerëz të tjerë këtu. Nisem ndodh ndonjë gjë, janë të vdekur minimumi 20 persona, minimumi (thotë duke qeshur)

FRIKA E MOISIUT PËR TRADHTI

M: E për furgonin e policisë që kaloi pak më parë? Janë të gjithë tanët këtu, por nëse ka ndonjë tradhtar s'e dimë. Ai telefonoi për sallën e kontrollit. Salla është në anën tjetër të portit, është në kryeqytet dhe nga atje ai sheh çdo gjë, edhe peshqit i sheh që atje. Sepse është

miku i një mikut tonë. Po si ka mundësi që e pyetën se e kujt është kjo anije? Dhe ai iu tha "për çfarë anije po flit"? Po si ka mundësi që ka hyrë një mijë në ujërat territoriale greke? (Momentet kur peshkarexha do linte molin, Moisiu i porositi)

M: Tani duhet të largohemi 2 mijë që këtej nga toka dhe duhet të lëvizim gjithmonë drejt. Sapo të mos shihem më dritat tona. Më telefonoi polici që më shpjegoi, por mos iu afro ujërave greke. Duhet të shkosh vetëm drejt.

Biseda për "shtetin" (Makina është në lëvizje dhe në bord janë Meridian Sulaj dhe Nezar Seiti)

Nezar: Do vij në mëngjes të të këtë gjë në shtëpi.

Meridian: Unë nuk mund të vij se mund të kishim ikur edhe bashkë.

Nezar: Jo s'mund të vish, e ke harruar?

Meridian: Jo drejtin, s'mund të vij

Nezar: Të merrja unë nuk ishte problem, po nuk vonohemi mos ki merak. Nuk e kapim fundin.

Meridian: E di e di.

Nezar: Kur të shkoj në Shqipëri.

Meridian: Dhe nuk të kanë dërguar gjë të kanë thënë.

Nezar: Më tha sot Lolo (Florian Habilaj)

Meridian: Jo.

Nezar: "Nuk i kemi punët mirë me ata të shtetit". E kam telefonin në shtëpi dhe nuk na telefonojnë më atë të degës së brendshme (se unë kështu i quaj ata, dega e

brendshme) kur kalojnë këta të policisë, "po kalon siguri i shtetit"

EUROT NË KOSOVË

Seiti: Drejt ta hajë, duhet të shkoj edhe në Prishtinë sapo të zbris në Vlorë

Sulaj: Hee, për atë (Flasin duk ulur zërin.)

Seiti: Nuk e arrij dot në kohë, sepse ai mbyllet në orën 14:00. Nga ora 08:00 deri në 14:00 për shembull nëse ti shkon se ke për të marrë 200 mijë euro... ai të thotë për sot kam bërë vetëm 100 mijë.

Sulaj: Janë preciz vlla

Seiti: Ai atje... në Prishtinë... ai i ka dorëzuar 200 mijë, por ky që bën transaksinon... ka fituar 14 mijë euro, 100%.

Sulaj: I merr ai?

Seiti: Por normal, ajo është puna e tij.

Sulaj: Po për këtë transaksinon, merr vetëm nga ty apo edhe nga ai tjetri?

Seiti: Jo...jo... unë s'kam të bëj... unë marr lekët cash... kam bërë marrëveshjen që në Milano... për të marrë lekët unë shkoj në Prishtinë... sepse këtu nuk mund të marrësh lekë cash.

Sulaj: Po...

Seiti: Çfarë bën? Unë mund të shkoj direkt... dhe të marr në një orë 140 mijë euro.

Sulaj: Janë shumë të organizuar ata...

Seiti: Nuk ka kështu... jo prit nesër... jo sa ke... merr lekët dhe kaq.

Seiti: Ti mos shih se si i marrim ne paratë kështu... se paratë t'i marrin e t'i sekuestrojnë kështu siç i marrin ne.

SITUATA POLITIKE REAGIMET

Kryeministri flet pas tryezës së opozitës: Fronti i vjetër i gjithë në "çadër"

Edi Rama: PD-LSI nuk duan shtet serioz, ne mbajmë përgjegjësi

"S"jemi të pagabueshëm, kemi edhe ne dru të shtrembër"

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama e cilësoi dje "fronti i vjetër" tryezën e partive të opozitës, ndërsa dekalroi se maxhoranca merr përgjegjësi për çdo gjë që nuk është bërë mirë. Në një reagim të tij, pas tryezës së organizuar nga PD e LSI, Rama u shpreh: "Asgjë e re nga fronti. Asgjë e re nga fronti i vjetër, përveç faktit që sot nuk janë më ca në "çadër" e ca me "çadrën", po janë të gjithë brenda në "çadër", me po ato maska që as skuqen, as zverdhën kur i marrin shqiptarët për budallenj; me po atë paaftësi për të marrë përgjegjësi mbi vete, për katandisjen e institucionit të opozitës në një sharëtorë publike; me po atë hipokrizi të skajshme të tërë këtyre viteve, si në pushtet e si në opozitë, ku vazhdojnë me po atë këngë të vjetër, të cilën e dëgjojnë vetëm shurdhët me veshët në rregull". Sipas Ramës, drejtuesit e opozitës "S'duan as shtet serioz, as drejtësi të drejtë, as luftë me krimin e me plagët e trashëguara prej pushtetit të tyre të vjetër. Duan vetëm pushtet për vete, në një shtet si ai që na lanë copa e çika katër vjet më parë, me një drejtësi që komandohet prej pushtetit të tyre dhe një ekonomi që rritet vetëm në oborrin e tyre të pushtetit".

"Ne jemi ndryshe dhe po luftojmë përditë që të bëjmë shtet, punë, mirëqenie për Shqipërinë që duam. Nuk jemi aspak të pagabueshëm. Nuk jemi aspak të paprekur nga sëmundjet e një çerekshkulli pa shtet, pa rregulla e norma dhe pa ndëshkueshmëri. Nuk jemi aspak një familje e përsosur, pa probleme e pa drurë të shtrembër në mesin tonë", vijoi më tej, kryeministri. "Por, u shpreh Kryeministri, ndryshe nga këta të frontit të "çadrës" së vjetër, ne marrim përgjegjësi për Shqipërinë dhe mbajmë përgjegjësi për çdo gjë që nuk e bëjmë mirë apo që del në dritën e realitetit si problem i yni". "Sot, kur e tërë opozita me kuq e me maq, u zhyt si front në çorbën e dy krimineleve të arrestuar në Itali, është dita të kujtojmë se në 20 vitet e fundit, ka patur plot raste kur politikanët, deputetë e familjarë të tyre janë përfshirë në akuzat publike. Disa herë akuzat kanë dalë të vërteta, shumë herë jo. Por, ndryshe nga paraardhësi im, nuk mund të jem unë ai që përcautoj fajin apo pafajësinë. Kjo është detyrë e siste-



Kryeministri
Edi Rama



Tryeza e partive
të opozitës

Gruevski pret Ramën: Shqipëria të na mbështesë në NATO

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama u prit në takim nga kryetari i VMRO-DPMNE-së, Nikola Gruevski. Nga zyra e shtypit të Gruevskit citohet të ketë thënë se është pro "bashkëpunimit të hapur me Shqipërinë e cila bazohet në baza të principeve. "Sipas tij, është e mirëseardhur mbështetja e Republikës së Shqipërisë për integrim në NATO dhe se ekzistojnë sfida të përbashkëta për përparim në rrugën drejt Bashkimit Evropian, në përmirësimin e të cilave bashkëpunimi është i mirëpritur.

"Tahiri", Balla mbledh deputetët: Nuk mbajmë anë, çështje ligjore

Kryetari i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla mbledhi dje grupin parlamentar të PS-së, një ditë pas skandalit të përgjimeve, ku implikohet emri i ish-ministrit Saimir Tahiri. Në mbledhjen që u zhvillua në kryesinë e Kuvendit, e ku më shumë ishin deputetët të komisionit të ligjeve, Balla është pyetur në lidhje me qëndrimin që duhet të mbajnë për këtë çështje. Ai mësohet t'u ketë thënë deputetëve që nuk duhet të pozicionohen, por të kenë qasje juridike. "Ju jeni juristë. Mbani qasje juridike ndaj çështjes. Ne nuk pozicionohemi e nuk mbajmë anë", mësohet të jetë shprehur Balla. Pas mbledhjeve që patën, deputetët të ndryshëm pothuaj dhanë të njëjtën përgjigje, të pyetur nga media se çështja duhet t'i lihet në dorë drejtësisë. "Unë besoj, por t'ia lemë drejtësisë", tha Vasilika Hysi. "Besoj të drejtësia, duhet të besoj të drejtësia, po luftojmë ta bëjmë këtë të mundur", tha Mimi Kodheli. "Akuza kanë të gjithë politikanët, por kur të fillojë procesi do e shohim a është fajtor apo jo", tha Tom Doshi.




mit të drejtësisë dhe është drejtësia që duhet të zbardhë deri në fund të vërtetën", bëri të qartë kreu i qeverisë. "Paraardhësi im në qeveri e çoi Shqipërinë buzë gremisë vetëm e vetëm për të mbrojtur djalin dhe vajzën e tij. Lideri i sotëm i opozitës përdori një raport mjekësor për

të djegur afatet e gjyqimit për një akuzë të ngritur nga prokuroria për korrupsion. Por ne nuk jemi të gjithë njësoj. Ne jemi ata që punuam dhe luftuam për vettingun dhe reformën në drejtësi (Ju kujtohet mirë besoj që të gjithë këta të frontit i kishim kundër e na bënë qepaze në syt? e

Ambasadori britanik: Mbi 600 shqiptarë janë në burg për drogë

Norman Duncan: Sekuestroni pasuritë e krimit, ju mbështesim

Ambasadori britanik në Shqipëri nuk ka pranuar të komentojë përgjimet e fundit në dosjen e drejtësisë italiane dhe ku pretendohet lidhja e politikës me krimin, por ka thënë se në vendin e tij mbetet ende i madh numri i shqiptarëve që merren me aktivitetet kriminale. I pyetur nga mediat, Duncan tha se sfida mbetet sekuestrimi i aseteve të siguruar nga aktiviteti kriminale. Ambasadori i Britanisë, i njohur për deklaratat e tij të forta për situatat politike në Shqipëri, nuk ka pranuar të komentojë skandalin më të fundit ku pretendohet lidhja e politikës me trafikun e drogës. I pyetur për këtë Norman Duncan nuk ka folur për këtë skandal, por nuk ka nguruar të flasë. Shqetësim i madh në Britani mbetet



Ambasadori britanik
Norman Duncan

përfshirja e shqiptarëve në trafikun e drogës dhe krimin e organizuar. "Më shumë se 600 shqiptarë janë në burg në Britaninë e Madhe, dhe shumica për trafikim droge. Situata është shqetësuese. Rreth 60% e shqiptarëve që vijnë në vëmendje të autoriteteve britanike, vijnë nga rrethet e Shqipërisë, Kukësi, Dibra dhe Shkodra, zona që përbëjnë

15% të popullsisë së vendit", tha Duncan. Ambasadori risolli në vëmendje faktin se një pjesë e mirë e të ardhurave të përfituara nga trafiku e paligjshme janë investuar në Shqipëri. Ndaj diplomatit britanik thekson bashkëpunimin mes dy vendeve për sekuestrimin e aseteve të krimit mbetet i rëndësishëm. "Kemi pasur bashkëpunim me autoritetet shqiptare për sfidat e përbashkëta. Ne po punojmë me Ministrinë e Brendshme dhe pjesë të tjera të qeverisë në projekte bashkëpunimi e mbështetjeje, në mars kur ministri i Sigurisë, Ben Wallace u takua me ministrin e Financave dhe diskutoi për sekuestrimin e aseteve të krimit dhe ndihmën që mund të japë Britania e Madhe", u shpreh ambasadori britanik.

Amerikës e të Europës se nuk e donin as reformën, as vettingun!). Ne sot jemi plotësisht të angazhuar që vetingu të bëhet deri në fund dhe drejtësia e re më në fund të vendoset, për të gjithë, pa asnjë dallim", nënvizoi Rama. "Ndërkohë na vjen shumë mirë që të mbledhurit në front,

nuk e përmendim më kanabisin si problem aktual. Dhe ndryshe nga ata që duan të përdorin muhabetet e krimineleve, në luftën e tyre të dëshpëruar për pushtet, ne do të vijojmë luftën e nisur tanimë kundër rrjeteve kriminale dhe aseteve të përfituara nga krimi", u shpreh Rama. "Për

aq kohë sa jemi në vijën e parë të luftës, kemi marrë parasysh edhe plagët, por edhe balancën, që sjell kjo betejë aspak e lehtë. Por ama ne nuk dorëzohemi dhe do të vazhdojmë të luftojmë krimin dhe kriminelët deri në fund, për Shqipërinë që duam", e mbylli reagimin e tij, kryeministri.



Tri vendimet e tryezës, deklarata e partive opozitare: Të ikë Rama

Krimi, Basha: Qeveri antimafie, Kryemadhi: Luftë narko-shtetit

"Prokuroria të hetojë Tahirin dhe ministrat e tjerë"

Valentina Madani

Fronti i Bashkuar Opozitar kërkon krijimin e një qeverie antimafie dhe përbushjen e reformës zgjedhore, me qëllim shembjen e lidhjeve të krimit me politikën dhe garantimin e zgjedhjeve të lira, si e vetmja rrugë për t'i kthyer legjitimitetin qeverisë". Opozita shpalli dje krijimin e Frontit të Bashkuar Opozitar kundër krimit dhe kërkesat i kanë të qarta: largimin e kryeministrit Edi Rama, si përgjegjës kryesor i lidhjeve të krimit me qeverinë; krijimin e një qeverie të antimafie dhe zbatimin e reformës zgjedhore me mandat të përcaktuar, që ta çojë vendin drejt zgjedhjeve për të rivendosur legjitimitetin. Ky front opozitar shpreh gjithashtu mbështetjen për zbatimin e reformës në drejtësi, për të siguruar dekriminalizimin e politikës dhe ndëshkimin e drejtuesve të lartë të shtetit të implikuar në afëra korruptive, pasuruar në mënyrë të paligjshme, të lidhur me krimin e narkotrafikut. Opozita e bashkuar i kërkon prokurorit të përgjithshëm të nisë urgjent dhe të kryejë me shpejtësi, në përputhje me dispozitat kushtetuese e ligjore, hetimin për ish-ministrin Saimir Tahiri dhe në bashkëpunim me autoritetet homologe italiane dhe të tjera të ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme për të vënë para drejtësisë të gjithë individët e implikuar në trafikun e drogës dhe të armëve. Gjithashtu, të hetojë edhe lidhjet e ministrave të tjerë të kësaj qeverie e tyre në bashkëpunimin kriminal për blerjen e votës më 25 qershor.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

LULZIM BASHA

"Fronti i bashkuar opozitar kërkon largimin e kryeministrit Edi Rama si drejtuesi dhe përgjegjësi i narko-shtetit. Përfutjesi i drejtpërdrejtë i lidhjeve mafioze të tij dhe ministrave të tij me narko-trafikanët dhe trafikantët e armëve", tha z.Basha.

MONIKA KRYEMADHI

"Sa për protestat, ato nuk vijnë nga partitë politike, por nga populli, vijnë nga përbrenda. Është momenti që së bashku të gjithë të veprojmë, se jemi në fund të tranzicionit politik. Jemi një nga vendet e fundit ish-komuniste që po kalojmë tranzicionin politik", tha ajo.

Dokumenti, Habilaj rekomandoi për anëtar partie babain e Tahirin

Kryetari i Departamentit për Politikën e Jashtme në PD, Kreshnik Çollaku, publikoi dje një dokument të Arkivit Qendror të PPSH, në fund të viteve '70, në një kohë që ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri, për shkak të skandalit të përgjimeve për bandën e Moisi Habilajt në Itali del si i implikuar. Në këtë dokument, që daton më 10 janar të '77-ës thuhet se Mevlan Habilaj rekomandon për anëtar partie shokun Bashkim Tahiri (ati i Saimirit, ministër i Brendshëm 2013-2017. "Sipas dokumenteve të Arkivit Qendror të PPSH, në fund të vitit 1970, shoku Mevlan Habilaj rekomandon për anëtar partie shokun Bashkim Tahiri (ati i Saimirit, ministër i Brendshëm 2013-2017...", shkruan z.Çollaku.



PLL, Gjana: Pse e refuzova tryezën e opozitës

Një ndër aleatët e Lulzim Bashës refuzoi ftesën e këtij të fundit për t'u bërë pjesë e tryezës opozitare për aksionin kundër krimit. Kreu i Partisë Lëvizja e Legalitetit, Sulejman Gjana, zbuloi arsyen pse nuk është bërë pjesë e kësaj tryeze, duke thënë se është kryetar në largim i PLL. "Përderisa unë jam në largim nga detyra e kryetarit, nuk mund të angazhohj sot PLL në një 'aksion' të përbashkët me PD, aq më tepër kur nuk kemi asnjë garanci se PD mund të mbrojë kauza që kalojnë interesin partiak apo thjesht vetjak dhe se mund t'u qëndrojë angazhimeve të veta me partnerët dhe qytetarët shqiptarë. Besoj se kryetari i ardhshëm i PLL dhe kryesia e re do të mund të marrin vendimin e duhur në raport me pozicionin dhe aksionin e ardhshëm të PLL", shprehet z.Gjana.



"Ish-oficeri i Krimeve, që drekon me Habilajt"

Berisha: Kodheli ua besoi trafikantëve qendrën e radarëve

Ish-kryeministri Sali Berisha denoncoi dje në 'FB' një ish-oficer të Krimeve, që sipas tij ka drekuar me Moisi Habilajn, i arrestuar në Itali si pjesë e një bande të trafikut të drogës dhe që është një kushëri i largët i ish-ministrit Saimir Tahiri. Berisha shprehet se në foton e publikuar shihet ish-oficeri i Krimeve, Sokol Bode, tashmë i emëruar si shef përgjimesh në Shkodër duke drekuar me Habilajt, ndërsa sipas tij lidhjet e narko-trafikut me policinë janë skandalozë. "Në narko-shtetin e Noriegës, narko-bandat kanë kumarbarë e tyre në përgjimet e policisë. Ata na përgjojnë ne. Ky është narko-shteti! Vetëm rrëzimi i Noriegës dhe narko-shtetit të tij është zgjidhja e vetme!", shkruan z.Berisha. Po dje



Ish-kryeministri Sali Berisha

në një tjetër status në 'FB', Berisha theksoi se me urdher të Ramës, ish-ministria e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, u kishte besuar bandave të drogës qendrat e radarëve. Mes të tjerash, Berisha thekson se e vetmja zgjidhje është rrëzimi i kryeministrit Rama. "Qytetarë, ky është narko-shteti! Në narko-shtetin e Noriegës, sipas përgji-

meve të partnerëve italianë, për kontrollin e radarëve të detit me urdher të Noriegës, ndrikull Kodheli ua kishte besuar narko-bandave duke emëruar njerëz të tyre në qendrën e radarëve. Vetëm rrëzimi i Noriegës do t'i shpëttojë shqiptarët nga narko-shteti i tij!", thuhet në mesazhin e ish-kryeministrit Berisha.

mazhorancë të kapur nga krimi? Përgjigja për çdo shqiptar është, "jo", tha Basha. Opozita akuzon ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri se është i lidhur me trafikun e drogës Shqipëri-Itali, trafik i cili siç pretendojnë Basha dhe Kryemadhi, është kryer në dijeni të Ramës. "Ky front do nisë anëtarë të tij kundër narko-shtetit, që përfaqësohet dhe drejtohet nga Edi Rama. E rëndësishme është që të gjitha partitë që morën pjesë

ishin të shqetësuara nga situata në Shqipëri, për inkriminimin e shtetit dhe institucioneve. Kjo është fatkeqësia e një vendi, shteti dhe një kombi. Tërëja ishte një sinjal për opinionin publik, mediat dhe ata që bojkotuan zgjedhjet", u shpreh Kryemadhi. Basha dhe Kryemadhi nuk folën për protestat si një opsion i këtij fronti opozitar, por kjo nuk do të jetë tryeza e vetme që do të bëjë bashkë opozitën në javët që vijnë. PD dhe LSI

tashmë janë zyrtarisht në aleancë. Ndërkohë, veç partive të djathta, me ta u ul edhe Koço Kokëdhima i 'Zgjidhjes'. Arsyet e cilën Ben Blushi i LIBRA-s e përdori si argument për mungesën e tij në tryezë. "Unë ika nga PS për shkak të Koços dhe nuk mund të vij e të uler në tryezën e opozitës dhe të gjej prapë Koçon", mësohet t'u ketë thënë Blushi organizatorëve të tryezës. Por, z.Basha e zj.Kryemadhi ftesën e lanë të hapur.

Projektbuxheti 2018/ Qeveria do të mbledhë nga taksa mbi pronën 21 mln euro më shumë

Ornela Manjani

Kompensimi i pronave, 500 milionë lekë më pak për ish-pronarët

Plani i Financave për të rritur të ardhurat me 200 milionë euro

Ministria e Financave po i jep "dorën e fundit" projektbuxhetit për vitin 2018. Qeveria pret të realizojë të ardhura në sasinë 200 milionë euro më shumë se në 2017 dhe rreth 21 milionë euro prej tyre do të vijnë nga taksa mbi pronën. Një zë i rëndësishëm në buxhet është kompensimi i pronave. Fondi special parashikohet të jetë në 1.5 miliardë lekë, apo 500 milionë lekë më pak se në 2017-ën për kompensimin e pronave pagesat do të kryhen sipas rendit kronologjik. Agjensia e Trajtimit të Pronave ka shqyrtuar dosjet nga viti 1993-1995. deri tani është kryer pagesa epër gjysmën e dosjeve që kanë marrë një vendim njoheje. Pjesa tjetër pritet të kompensohet vitet në vijim.

TAKSA

Qeveria ka bërë publik planin për të ndryshuar taksimin mbi pronën nga fikse, në bazë të vlerës. Në projektbuxhetin 2018, pritsmëria për të ardhurat nga taksa e pronës është rritur ndjeshëm në raport me programin afatmesëm të Financave. Arkëtimin nga taksa e pronës pritet të rritet me 54%, për të arritur në 8.1 miliardë lekë në raport me pritsmëritë e 2017-ës. Pra, shqiptarët do të paguajnë rreth 60 milionë euro taksë për pronën, apo rreth 21 milionë euro më shumë se këtë vit. Në raport me Prodhimin e Brendshëm Bruto, të ardhurat nga taksa e pronës pritet të arrijnë në 0.5% të

PBB-së, në linjë me rekomandimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar.

PROJEKTBUXHETI

Ministria e Financave ka hartuar tabelat paraprake të buxhetit të vitit 2018. Sipas planit, totali i të ardhurave për vitin 2018 pritet që të arrijë 464.3 miliardë lekë (rreth 3.4 miliardë euro), me një

ritje prej 6.4% në krahasim me aktin normativ 2017, apo rreth 200 milionë euro më shumë se të ardhurat që pritet të mblidhen këtë vit. Në raport me Prodhimin e Brendshëm Bruto, të ardhurat pritet të arrijnë që në vitin 2017 një nivel rekord prej 28.1% të PBB-së dhe ky nivel pritet që të ruhet edhe

përgjatë vitit 2018. Parashikimi i fundit zyrtar për rritjen ekonomike, sipas programit afatmesëm të qeverisë është për një rritje prej 4.1% dhe një inflacion prej rreth 2%, çka nënkupton që projektimi real për rritjen e të ardhurave, duke hequr rritjen ekonomike dhe inflacionin është minimal. Të

PREZANTIMI

Të ardhurat nga sigurimet shoqërore pritet të rriten me 6.2%, 74.6 miliardë lekë. Hyrjet nga sigurimet shoqërore do të zgjerohen me 7%, 11.9 miliardë lekë. Të ardhurat jotatimore pritet të zgjerohen me 5.6%, 25.7 miliardë lekë.

ardhurat tatimore, të cilat sigurojnë 91.5% të totalit të hyrave në buxhet, pritet që të rriten me 6.7% (+26.8 miliardë lekë), për të arritur në 425 miliardë lekë.

Të ardhurat nga tatimet dhe doganat, që do të sjellin 63% të totalit të buxhetit, pritet të rriten me 5.9% (17.8 miliardë lekë), duke arritur

në 317.2 miliardë lekë. TVSH-ja si gjithmonë do të mbajë peshën kryesore në të ardhurat nga tatimet e doganat, duke siguruar 47.5% të tyre. Në vlerë absolute, të ardhurat nga Tatimi i Vlerës së Shtuar pritet të arrijnë në 150.7 miliardë lekë, me një zgerim vjetor prej 6.8% në raport me pritsmërinë e këtij viti. Qeveria ka në plan që këtë vit të zgjerojë skemën e TVSH-së edhe tek biznesi i vogël. Megjithatë, në buxhet, plani për TVSH-në mbetet në 9.1% të PBB-së, njësoj si në vitin 2017. Sipas draftit, të ardhurat nga tatim-fitimi do të arrijnë në 33.4 miliardë lekë, me një pritsmëri për një zgerim të ndjeshëm prej 14.4% me bazë vjetore. Ndërkohë nga akciza pritet të grumbullohen 50.4 miliardë lekë, me një rritje me bazë vjetore prej 7.9% në raport me pritsmëritë e 2017-ës. Tatimi mbi të ardhurat personale pritet të ketë një rritje modeste prej 3% për të arritur në 37.3 miliardë lekë. Qeveria ka bërë publik planin për të ulur tatimin mbi pagat e larta nga 23% në 18%, por deri tani nuk ka sinjale se kjo do të ndodhë brenda vitit 2018.

EMERTIMI	Akt normativ 2017		Buxheti 2018		Ndryshimi në vlerë 2018/2017	
	Ne % te PBB	%	Ne % te PBB	%	Ndryshimi në %	%
TOTALI TE ARDHURAVE	436,401	28.1%	464,292	28.1%	27,891	6.4
Te ardhura nga ndihmat	13,800	0.9%	14,500	0.9%	700	5.1
Te ardhura nga taksat	399,201	25.6%	425,045	25.7%	26,834	6.7
Nga Tatimet dhe Doganat	299,400	19.3%	317,187	19.2%	17,787	5.9
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	141,200	9.1%	150,734	9.1%	9,534	6.8
Tatimi mbi Fitimin	29,200	1.9%	33,413	2.0%	4,213	14.4
Akcizat	46,700	3.0%	50,400	3.1%	3,700	7.9
Tatimi mbi të Ardhurat Personale	36,200	2.3%	37,300	2.3%	1,100	3.0
Taksa Nacionale dhe të tjera	39,700	2.6%	38,340	2.3%	-1,360	-3.4
Taksa Doganore	6,400	0.4%	7,000	0.4%	600	9.4
Te ardhura nga Pussteti Vendor	17,400	1.1%	18,767	1.1%	1,367	7.9
Taksa Lokale	11,646	0.7%	10,345	0.6%	-1,300	-11.2
Tatimi mbi Pasurine (ndertesat)	5,272	0.3%	8,139	0.5%	2,867	54.4
Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël	483	0.0%	302	0.0%	-180	-37.4
Te ardhurat nga Fondet Speciale	83,400	5.4%	88,062	5.3%	4,662	5.6
Sigurimi Shoqëror	70,268	4.3%	74,656	4.3%	4,388	6.2
Sigurimi Shëndetësor	11,132	0.7%	11,906	0.7%	774	7.0
Te ardhurat për kompensimin në vlerë të pronave	2,000	0.1%	1,500	0.1%	-500	-25.0
Te ardhura Jotatimore	24,400	1.6%	25,757	1.6%	1,357	5.6
Tran. Fitimi nga Banka e Shqipërisë	1,000	0.1%	1,000	0.1%	0	0.0
Te ardhura nga Institucionet Buxhetore	15,470	1.0%	15,977	1.0%	507	3.3
Dividenti	800	0.1%	800	0.0%	0	0.0
Tarifat e Shërbimeve	3,300	0.2%	3,400	0.2%	100	3.0
Të tjera	3,830	0.2%	4,580	0.3%	750	19.6

Elizir: Ministria e Financave

Anti-informaliteti, ministri paralajmëron bizneset

TVSH-ja, Ahmetaj: Mbi 60 mijë biznese përjashtohen nga deklarimi

Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj, në një takim me biznesin e vogël deklaroi se të paktën 60-65 mijë biznese do të mbeten të përjashtuar nga nisura e deklarimit të TVSH-së. Logjika e këtij vendimi, sipas ministrit, është e thjeshtë. Ata që jetojnë me prodhimet e tyre dhe nuk janë pjesë e një zinxhiri më të gjatë tregtimi nga prodhuesi tek konsumatori final nuk do deklarohen. "Në diskutimin që kemi pasur me kryeministrin dhe stafet, ne jemi shumë të qartë që biznesi i vogël i disa kategorive të veçanta dhe këtu i referohem zejtarisë, taksistit, fermerit do të jenë të përjashtuar nga TVSH-ja, ambulantët në tregjet e bashkive gjithashtu. Pra, ai që shet fruta-perime në Lushnjë, Divjakë, Fier nuk është pjesë e detyr-



Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj

imit. Kjo pjesë e sipërmarrjes që jeton me punën e vet nuk do jetë në TVSH, por detyrimin e ka ajo pjesë e biznesit, që është pjesë e transaksioneve që rrjedhin

nga biznesi i madh dhe që blejnë në zinxhir. Biznesi i vogël me një numër 60-65 mijë do mbetet i përjashtuar jashtë skemës së deklarimit të detyrueshëm të

TVSH-së", tha Ahmetaj. **ANTI-INFORMALITETI** "Logjika jonë për të shtrirë TVSH-në nga zero ka qenë anti-informaliteti. Ne e kemi këtë problem me prap dhe kjo bën që bizneset të mos marrin fatunën. Buxheti i shtetit duhet të marrë atë që i takon, pastaj përmes instrumenteve sociale, investimeve në rrugë apo spitale, ujësjellës apo mbështetjes me ndihmë ekonomike apo siç është me pensionistet, me subvencion për energjinë dhe ilaçet, këto janë instrumentet me të cilat ndihmon shteti. S'ka justifikim se janë të vegjël. Ndesheni me konkurrencë të pandershme", tha Ahmetaj. Sipas tij, kjo lëvizje nuk do të ketë impakt në rritjen e cmimit.

Raporti i INSTAT: Rritet kriminaliteti në ekonomi

Kriminaliteti në ekonomi në tremujorin e tretë të vitit 2017 ka shënuar rritje të ndjeshme në vend, duke kaluar për herë të parë në histori si krimi kryesor në vend", raportoi INSTAT. Në tremujorin e tretë të 2017-ës janë kryer 9.900 vepra penale, rreth 10,3% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016. Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 10.068 autorë të veprave penale, të cilët janë 23,8% më shumë krahasuar me tremujorin e tretë 2016-ës. Pjesën më të madhe të veprave penale e zënë "Krimet kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike" me 40,3%, "Krimet kundër autoritetit të shtetit" me 38,3% dhe "Krimet kundër personit" me 19,0%. Në vlerë absolute, numri i veprave të evidentuara në grupin penal "Krimet kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike" në tremujorin e tretë arriti në gati 4 mijë, me një rritje prej 47% në krahasim me tremujorin e tretë 2016, ku rritjen më të fortë e kanë ndërtimet e paligjshme dhe ato të fushës e tati-meve dhe taksave. Në tremujorin e tretë 2017 janë kryer 3.993 vepra penale "Krimet kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike", duke pësuar rritje me 46,8%, krahasuar me tremujorin e tretë 2016. Autorët e tyre janë 3.506, rreth 53,6% më shumë se në të njëjtën tremujor të një viti më parë dhe përbëjnë 34,8% të totalit.



SHENIMI Kur dokumentacioni është i rregullt shënohet me V, kur mungon shënohet me X, kur janë autorizuar me prokurë shënohet me P.																		
ISHI DËNARI POLITIK			TRASHEGIMTARË TË PARE				TRASHEGIMTARË TË DVYTE				DOKUMENTAT							
NR. DOSËS	EMER	MBIEMER	VKM NR.	EMER	ATESIA	MBIEMER	DATELIN	VENDLN	EMER	ATESIA	MBIEMER	VENDLN	KOPE TE LETER NJOFTIM	NUMER PERSONAL LLOGARIT BANKARE	CERTIFIKATE VDEKJE	CERTIFIKATE TRUNGU T FAMILJAR	DESHMI TRASHGIMIE	PROKURE
9638	Zemel	Muhadri	599	Ferdie	Zemel	Muhadri							V	V	V	V	V	

Doje e plotë për kësht të Pare shqyrtuar në datën 01.06.2017

Zemel e trashëgoje Ferdie.

SHENIMI Kur dokumentacioni është i rregullt shënohet me V, kur mungon shënohet me X, kur janë autorizuar me prokurë shënohet me P.																		
ISHI DËNARI POLITIK			TRASHEGIMTARË TË PARE				TRASHEGIMTARË TË DVYTE				DOKUMENTAT							
NR. DOSËS	EMER	MBIEMER	VKM NR.	EMER	ATESIA	MBIEMER	DATELIN	VENDLN	EMER	ATESIA	MBIEMER	VENDLN	KOPE TE LETER NJOFTIM	NUMER PERSONAL LLOGARIT BANKARE	CERTIFIKATE VDEKJE	CERTIFIKATE TRUNGU T FAMILJAR	DESHMI TRASHGIMIE	PROKURE
2028	Isuf	Devishi	196	Dali	Isuf	Devishi							V	V	V	V	V	

Doje e plotë për kësht të Pare shqyrtuar në datën 31.05.2017

Artin e trashëgoje prindit Perparim dhe Qirace, Perparim e trashëgoje Qirace dhe Roland. Qirace merri pjesën e sajë dhe ka prokurë për Roland.

SHENIMI Kur dokumentacioni është i rregullt shënohet me V, kur mungon shënohet me X, kur janë autorizuar me prokurë shënohet me P.																		
ISHI DËNARI POLITIK			TRASHEGIMTARË TË PARE				TRASHEGIMTARË TË DVYTE				DOKUMENTAT							
NR. DOSËS	EMER	MBIEMER	VKM NR.	EMER	ATESIA	MBIEMER	DATELIN	VENDLN	EMER	ATESIA	MBIEMER	VENDLN	KOPE TE LETER NJOFTIM	NUMER PERSONAL LLOGARIT BANKARE	CERTIFIKATE VDEKJE	CERTIFIKATE TRUNGU T FAMILJAR	DESHMI TRASHGIMIE	PROKURE
19728	Glion	Lubi	599	Pjeter	Vlora	Lubi							V	V	V	V	V	

Doje e plotë për kësht të Pare shqyrtuar në datën 04.07.2017

Glion e trashëgoje Pjeter dhe Vlora e trashëgoje Pjeter.

SHENIMI Kur dokumentacioni është i rregullt shënohet me V, kur mungon shënohet me X, kur janë autorizuar me prokurë shënohet me P.																		
ISHI DËNARI POLITIK			TRASHEGIMTARË TË PARE				TRASHEGIMTARË TË DVYTE				DOKUMENTAT							
NR. DOSËS	EMER	MBIEMER	VKM NR.	EMER	ATESIA	MBIEMER	DATELIN	VENDLN	EMER	ATESIA	MBIEMER	VENDLN	KOPE TE LETER NJOFTIM	NUMER PERSONAL LLOGARIT BANKARE	CERTIFIKATE VDEKJE	CERTIFIKATE TRUNGU T FAMILJAR	DESHMI TRASHGIMIE	PROKURE
9550	Mark	Ndoja	502	Mark		Mirash (Ndoja)							V	V	V	V	V	

Doje e plotë për kësht të Pare shqyrtuar në datën 21.06.2017

Mark e trashëgoje Mirash.

SHENIMI Kur dokumentacioni është i rregullt shënohet me V, kur mungon shënohet me X, kur janë autorizuar me prokurë shënohet me P.																		
ISHI DËNARI POLITIK			TRASHEGIMTARË TË PARE				TRASHEGIMTARË TË DVYTE				DOKUMENTAT							
NR. DOSËS	EMER	MBIEMER	VKM NR.	EMER	ATESIA	MBIEMER	DATELIN	VENDLN	EMER	ATESIA	MBIEMER	VENDLN	KOPE TE LETER NJOFTIM	NUMER PERSONAL LLOGARIT BANKARE	CERTIFIKATE VDEKJE	CERTIFIKATE TRUNGU T FAMILJAR	DESHMI TRASHGIMIE	PROKURE
19728	Glion	Lubi	599	Pjeter	Vlora	Lubi							V	V	V	V	V	

Doje e plotë për kësht të Pare shqyrtuar në datën 04.07.2017

Glion e trashëgoje Pjeter dhe Vlora e trashëgoje Pjeter.

SHENIMI Kur dokumentacioni është i rregullt shënohet me V, kur mungon shënohet me X, kur janë autorizuar me prokurë shënohet me P.																		
ISHI DËNARI POLITIK			TRASHEGIMTARË TË PARE				TRASHEGIMTARË TË DVYTE				DOKUMENTAT							
NR. DOSËS	EMER	MBIEMER	VKM NR.	EMER	ATESIA	MBIEMER	DATELIN	VENDLN	EMER	ATESIA	MBIEMER	VENDLN	KOPE TE LETER NJOFTIM	NUMER PERSONAL LLOGARIT BANKARE	CERTIFIKATE VDEKJE	CERTIFIKATE TRUNGU T FAMILJAR	DESHMI TRASHGIMIE	PROKURE
9655	QAZIM	SHAFER RAI		JATIME	QAZIM	SHAFER RAI							V	V	V	V	V	

Doje e plotë për kësht të Pare shqyrtuar në datën 06.06.2017

Veli e trashëgoje Platon.

SHENIMI Kur dokumentacioni është i rregullt shënohet me V, kur mungon shënohet me X, kur janë autorizuar me prokurë shënohet me P.																		
ISHI DËNARI POLITIK			TRASHEGIMTARË TË PARE				TRASHEGIMTARË TË DVYTE				DOKUMENTAT							
NR. DOSËS	EMER	MBIEMER	VKM NR.	EMER	ATESIA	MBIEMER	DATELIN	VENDLN	EMER	ATESIA	MBIEMER	VENDLN	KOPE TE LETER NJOFTIM	NUMER PERSONAL LLOGARIT BANKARE	CERTIFIKATE VDEKJE	CERTIFIKATE TRUNGU T FAMILJAR	DESHMI TRASHGIMIE	PROKURE
2028	BARAM	VORA	509	KASEM	BARAM	VORA	07.05.1983	SHJAK	ARBEN	KASEM	VORA		V	V	V	V	V	

Doje e plotë për kësht të Pare shqyrtuar në datën 07.07.2017

Barjam e trashëgoje fëmijet Kasem, Skender, Zylha dhe Bajram. Pjesa e Bajram Vores ndahet me me vëllezërit dhe motrat: Kasem, Skender, Zylha, Pasi Bajram Vora ka vdekur 2 vjeç. Kasem e trashëgoje Arben, Ismet, Gentiana, Avni, Bajram dhe Anila.

Arben, Ismet, Gentiana, Avni, Bajram, Anila, Skender dhe Zylha du paguhen për kësht të Pare.

SHENIMI Kur dokumentacioni është i rregullt shënohet me V, kur mungon shënohet me X, kur janë autorizuar me prokurë shënohet me P.																		
ISHI DËNARI POLITIK			TRASHEGIMTARË TË PARE				TRASHEGIMTARË TË DVYTE				DOKUMENTAT							
NR. DOSËS	EMER	MBIEMER	VKM NR.	EMER	ATESIA	MBIEMER	DATELIN	VENDLN	EMER	ATESIA	MBIEMER	VENDLN	KOPE TE LETER NJOFTIM	NUMER PERSONAL LLOGARIT BANKARE	CERTIFIKATE VDEKJE	CERTIFIKATE TRUNGU T FAMILJAR	DESHMI TRASHGIMIE	PROKURE
19680	Shemsi	Kala	509	Kalosh	Shemsi	Kala							V	V	V	V	V	

Doje e plotë për kësht të Pare shqyrtuar në datën 07.07.2017

Shemsi e trashëgoje i biri Kalosh, Kalosh ka vdekur dhe nuk ka lene trashëgimtarë. Kalosh e trashëgoje me zëvendësues për Xhabullare e vdekur fëmijet e tyre që janë: Per Bilal paguhet Kurt, Nezir, Jus Zenepe, per Adem paguhet Ahmet, dhe per Halit paguhen Bukurije dhe Dife.

Per Nezir, Bukurije dhe Dife që janë po për kësht të Pare nuk du paguhen në plotësimin e dokumentacionit ligjor të sipërmenduar.

DOJE E PËRSHMË

QAZIM E TRASHËGOJË FEMIJET JATIME, KUDJESI, MUHAMMARE, ME ZËVENDËSIMË (PËR SHYQIR) JANI, DHIMTËR, VIDILCA, ANILA, FESTIM, ERION, ME ZËVENDËSIMË (PËR DRIT) SHPETIM, FIQIRET, ARIAN, MERITA VETEM MUHAMMARE DHE SHPETIM KANE PROTEKSION DOKUMENTOR

TRASHEGIMTARË TË TËRE DUHET TË DËLJAN SHKËRTIM NR. LLOGARIT BANKARE NË MENYRË QË TË BEHET PAGESA

Shemsi Kur dokumentacioni është i rregullt shënohet me V, kur mungon shënohet me X, kur janë autorizuar me prokurë shënohet me P.

ISHI DËNARI POLITIK			TRASHEGIMTARË TË PARE				TRASHEGIMTARË TË DVYTE				DOKUMENTAT							
NR. DOSËS	EMER	MBIEMER	VKM NR.	EMER	ATESIA	MBIEMER	DATELIN	VENDLN	EMER	ATESIA	MBIEMER	VENDLN	KOPE TE LETER NJOFTIM	NUMER PERSONAL LLOGARIT BANKARE	CERTIFIKATE VDEKJE	CERTIFIKATE TRUNGU T FAMILJAR	DESHMI TRASHGIMIE	PROKURE
2080	SHKËPASHI	MIRAJA		BIB	PASHUR	MERUEJA							V	V	V	V	V	

DOJE E KUJË

PASHUR E TRASHËGOJË FEMIJET ALDORA, KATERINA, ZEF PËR ALDORA MUNGON VERËTETIM NR. LLOG PËR KATERINA NUK PËRCAKTOHET QANTË LLOSHA ME ARBEN, PAS ARBEN KA ATËS DHE MËMESH TËTËR (E EMA QUNTË LËZË) PËR ZEF MUNGONË DOKUMENTACIONI TRUNGU FAMILJAR DHE VERËTETIM NR. LLOG

Doje e plotë për kësht të Pare shqyrtuar në datën 07.07.2017

Shemsi e trashëgoje i biri Kalosh, Kalosh ka vdekur dhe nuk ka lene trashëgimtarë. Kalosh e trashëgoje me zëvendësues për Xhabullare e vdekur fëmijet e tyre që janë: Per Bilal paguhet Kurt, Nezir, Jus Zenepe, per Adem paguhet Ahmet, dhe per Halit paguhen Bukurije dhe Dife.

Per Nezir, Bukurije dhe Dife që janë po për kësht të Pare nuk du paguhen në plotësimin e dokumentacionit ligjor të sipërmenduar.



Anëtarët e bandës së drogës italo-shqiptare të arrestuar në Durrës

Kapen në Durrës dy anëtarë të një bande mafioze në Itali

DURRËS - Dy anëtarë të një bande droge italo-shqiptare në Parma të Italisë janë arrestuar në qytetin e Durrësit. Pas një operacioni të zhvilluar në mars të vitit 2014 në Itali, kjo bandë u shkatërrua ku në përbërje kishte disa shqiptarë, të cilët fushin në Itali sasi të mëdha heroine të pastër dhe substanca të tjera,

me të cilat përzienin drogën në një laborator në Parma. Dy të arrestuarit janë Hektor Kosturi, 30 vjeç, me precedentë penalë dhe Erjon Shahini, 34 vjeç. Ky i fundit tashmë është ekstraduar në Itali dhe gjendet në burgun e Rebibias. Kosturi do të ndjekë me shumë mundësi të njëjtin rrugë, falë bashkëpunimit midis policive

të dy vendeve. Ai do të vuajë dënimin me tetë vjet burg dhe një gjobë 22 mijë euro. Ndërkaq, të arrestuarit në mars të vitit 2014 janë: Marcello Panariti, lindur në Taranto më 1980, burgosur në Colono; Velino Korovesi Velino, lindur më 1990, tashmë në burgun Arma di Taggia; Lauert Greca, lindur më 1990, banues

në Parma; Artur Bregu, i ditëlindjes 1981, i dënuar në burg në Brescello, i konsideruar si truri shpërndarjes së drogës, një punëtor që bënte jetë shumë modeste për të mos rënë në sy; Gëzim Hasa, 1984, pa leje qëndrimi në Itali, tashmë në burgun e Parmës; Denis Tafili, lindur më 1985, pa leje qëndrimi, në burgun e Parmës; Davide Cavalli, në arrest shtëpie; Ded Bajraktari Ded, lindur më 1991; Bledar Brahim Bledar, lindur më 1986, banues në Colono.

Të arrestuarit drejtonin shitjen e dozave nga brenda hoteleve

Seks në këmbim të kokainës, pranga 5 shqiptarëve në Itali

Kërcënimet, për të paguar lëndën narkotike

Egla Xhemali

ITALI

Një bandë me shqiptarë që kishte ngritur një rrjet për shpërndarjen e kokainës dhe marijuanës edhe mes minorëve duke shfrytëzuar si bazë mbështetjeje dhomat e marra me qira në disa hotele të zonës së Rosetos është shkatërruar nga policët e kompanisë "Giuliano". Hetime është koordinuar nga zëvendësprokurorja Silvia Scamurra. Janë arrestuar 5 shqiptarë në zona të ndryshme të Italisë me akuzën për shpërndarje narkotikësh në rrethana të rënduara dhe zhvatje. Të arrestuarit drejtonin shitjen e dozave nga brenda hoteleve, duke lehtësuar ardhjen e blerësve të rastit,



Foto ilustruese

mes tyre kishte edhe adoleshentë dhe gra, shumë prej të cilave detyroheshin të paguanin mallin me marrëdhënie seksuale. Shumë të tjerë kërcënoheshin kur ishin në vështirësi për të paguar dozat. Po ashtu, një rast jetër i një operacioni antidrogë në Bari është finalizuar me sukses. Policia italiane ka arrestuar 5 persona, mes të cilëve edhe dy shqiptarë. Në pranga kanë përfunduar shqiptarët Edison Hoxha 30 vjeç dhe Enea Ioannidou 32

vjeç, ky i fundit me banim në Gjermani. Gjithashtu, policia ka arrestuar italianët Giuseppe Lastella 53 vjeç, Francesco Lopez 46 vjeç, Paolo Piemonte 45 vjeç, si pjesë e bandës së trafikimit të lëndëve narkotike. Gjatë kontrollit të makinës, blutë sekuestruan 2,3 kg kokainë, që ishte fshetur në serbatorin e makinës si dhe 21,800 euro. Operacionet e policisë kanë filluar që në shtator, ku janë sekuestruar 4 tonë drogë dhe janë kapur 3 sh-

qiptarë. Analizat laboratorike të marijuanës vërtetuan se sasia e drogës ishte e një cilësie mjaft të mirë dhe u vlerësua se kishte një vlerë rreth 40 milionë euro e mund të sillte për organizatën e trafikantëve një përfitim prej 100 milionë eurosh. Prokurorja Francesca Pirrelli në konferencën për shtyp deklaroi se po hotohej mbi pronarin e jahtit të sekuestruar, i cili rezultonte me kalime të ndryshme pronësie mes Shqipërisë e Malit të Zi. Sasia e drogës ishte e sistemuar në pako me ngjyra të ndryshme, që sipas financiarëve italianë, kishte të bënte me klientët e klaneve të ndryshme që do merrnin dorëzim lëndën narkotike. Për autoritetet italiane, sasia e madhe e drogës së sekuestruar është tregues se ky nuk ishte një biznes në nivel provincine, por shumë më i gjerë.

SHKURT

Kërkoheshin për vrasje e drogë në Itali, arrestohen në Durrës

DURRËS - Policia e Durrësit ka arrestuar dy shtetas të shpallur në kërkim nga autoritetet italiane. Në pranga u vunë Gëzim Aleks i 41 vjeç, banues në Shijak dhe Dashamir Hersi, 48 vjeç, banues në Durrës. Arrestimi i tyre u bë me qëllim ekstradimin drejt shtetit italian. Gëzim Aleks akuzohet për veprën penale "Vrasja" parashikuar nga legjislacioni italian. Ndërsa, Dashamir Hersi për kryerjen e veprës penale "Trafikimi të lëndëve narkotike", parashikuar në nenin 110 të Kodit Penal italian.

Tentoi të vriste një person, vihet në pranga një 25-vjeçar

GJIROKASTËR - Një 25-vjeçar ka rënë në pranga, pasi ishte shpallur në kërkim për vrasje të mbetur në tentativë. Burime zyrtare nga policia e Gjirokastrës bënë me dije se Dilaver Rrapa, banues në Tepelenë akuzohet se në 2 korrik ka qëlluar me armë zjarri në drejtim të shtetasit O.M. Sipas policisë, ndalimi i tij u bë pasi ai akuzohej për veprat penale "Vrasje me dashje mbetur në tentativë", "Kanosje" dhe "Prodhim e mbajtje pa leje të armëve luftarakë dhe municionit". Ndaj tij, gjykata kishte caktuar në mungesë masën e arrestit me burg.

Vodhën 30 apartamente në Itali, në pranga dy kushërinjtë shqiptarë

ITALI - Dy të rinj shqiptarë kanë rënë ditën e martë në pranga, pasi akuzohen të jenë autorë të disa vjedhjeve. "Ansa" shkruan se dyshohet që dy kushërinjtë shqiptarë që nga viti 2015 kanë vjedhur në apartamente në zonat e Pesaro-s, Riçione-s dhe në Rimini. Mësohet se me anë të një mekanizmi me një shufër hekuri dhe kaçavida, shqiptarët ndërhyjnë në dritaret e banesave dhe më pas hyjnë brenda, duke vjedhur bizhuteri, para dhe rroba. Vetëm në zonën e Pesaro-s në Villa Fastiggi, nga qershori deri para pak ditësh, dy kushërinjtë kanë hyrë në 30 apartamente, duke siguruar sende me vlerë nga 1,500-2000 euro, të cilat dërgoheshin çdo javë në Shqipëri. Sakaq, policia italiane po heton lidhur me dokumentimin e plotë të ngjarjes.

Shqiptari elzekutohet me armë zjarri në Danimarkë, dëshimit

DANIMARKË - Një i ri shqiptar nga Maqedonia është vrrarë me armë zjarri pasditen e së martës në lagjen "Ragnhildgade" në Kopenhagen të Danimarkës, raporton media daneze "Ritzau". Ngjarja ka ndodhur rreth orës 21.05, ndërsa mediat maqedonase shkruajnë se i riu që ka humbur jetën është 16-vjeçari nga fshati Xhepçisht i Tetovës, i identifikuar me emrin Servet. Nuk dihen ende shkaqet dhe motivet e vrasjes së të riut, por dyshimet e para të policisë janë se krimin e ka kryer një bandë arabe.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes të ashensorëve në godinat e Bankës së Shqipërisë".

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 1,046,800 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10:00 – 13:00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të kenë bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në logarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutyesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes të ashensorëve në godinat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **09 Nentor 2017, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



Ambasada e Republikës Federale të Gjermanisë
Tiranë



Deutscher Akademischer Austausch Dienst
German Academic Exchange Service

Aplikimi për bursa 2018-2019

Shërbimi i Shkëmbimit Akademik Gjerman DAAD ofron edhe këtë vit bursa për qëndrime afatgjata dhe afatshkurtra studimi në Gjermani. Për këto bursa mund të aplikojnë studentët, absolventët si dhe shkencëtarët të të gjitha fushave:

- Bursa për kërkime shkencore për akademikë, për doktorantë dhe shkencëtarët të rinj, si edhe ish-bursantë të DAAD-së
- Bursa studimi për absolventë të të gjitha fushave (master)
- Bursa studimi për artistë
- Bursa për frekuencim të kurseve verore për studentët të përparuar nga të gjitha degët që kanë njohuri në gjermanisht

Afati i fundit i dorëzimit të aplikimit është:

- 30.09.2017 direkt në zyrën e DAAD-së në Bonn për degën Arkitekturë
- 31.10.2017 direkt në zyrën e DAAD-së në Bonn për degën Muzikë dhe Artet e Bukura
- 30.11.2017 direkt në zyrën e DAAD-së në Bonn për degën Film, Design
- 15.11.2017 pranë Ambasadës Gjermane për të gjitha degët e tjera
- 01.12.2017 pranë Ambasadës Gjermane për kursimet verore

Informacione për ofertat e mësipërme, kushtet e aplikimit, procedurat dhe formularët mund t'i merrni në faqet e mëposhtme: www.daad-al.org

Për pyetje të mëtejshme mund të na kontaktoni (oraret e konsultimit gjenden në www.daad-al.org)

Jonida Peza
peza@daad-al.org
(Asistente e lektoratit të DAAD-së Tiranë, kati I, në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës)

Dr. Jeanette Rieger-Cowdry
rieger-cowdry@daad-al.org
(Lektore e DAAD-së, në Tiranë, kati II, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Lëvizja "Për universitetin": Shumica e studentëve nuk po ndjekin degët e studimit që dëshirojnë

Aktivisti: Beteja jonë kundër ligjit të arsimit të lartë

Klodi Leka: Marrëdhënia student-pedagog, autoritare

Voltiza Duro

Me fillimin e vitit të ri akademik 2017-2018, lëvizja "Për universitetin", në tryezat informuese, ka ngritur zërin në lidhje me problematikat që hasin studentët. Pas një anketimi të realizuar nga kjo lëvizje, me të rinjtë që u ulën për herë të parë në auditore, është arritur në konkluzionin se shumë prej tyre nuk janë në degët që dëshirojnë. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Klodi Leka, student i Universitetit të Tiranës dhe njëkohësisht aktivist i lëvizjes prej 4 vitesh, tregon se misioni i tyre kryesor është vazhdimi i betejës për arsimin e lartë e për universitetin. Ai flet, gjithashtu, edhe për marrëdhënien autoritare student-pedagog e vështirësitë ekonomike që has çdo i ri në Shqipëri.

Cili është misioni i lëvizjes "Për universitetin"?



Studenti i Universitetit të Tiranës, Klodi Leka

Lëvizja studentore është krijuar në qershor të 2014 nga një grup bërthamë i përbërë nga studentë e pedagogë e numri i anëtarëve të kësaj lëvizjeje është gjithmonë në rritje. Misioni ynë kryesor është të vazhdojmë betejën për arsimin e lartë e për universitetin, pasi është e vetmja pasuri e madhe e popullit tonë dhe një shprehje sociale

e prindërve tanë që ne të bëjmë një jetë më të mirë se ata. Çdo ditë po hasim barrera shpesh edhe të dhunshme. Po punojmë në kushte të vështira, por rezistenca jonë do të vazhdojë.

Cilat janë disa nga problematikat që konstatuat ju si lëvizje studentore, me fillimin e vitit të ri akademik?


Problematikat vazhdojnë të mbeten po ato, madje shumë prej tyre janë të vjetra. Një nga problemet kryesorë që u diskutua në tryezat tona informuese është fakti që shumë prej studentëve nuk janë në degët që dëshirojnë për shkak të sistemit kaotik të regjistrimit në fakulteteve. Një problematikë tjetër janë dhe sallat e tërë mbushura, pasi mungojnë mjediset e mjaftueshme për të zhvilluar orët mësimore, funksionimi i dobët i bibliotekave e mungesa e materialeve të mjaftueshme në to. Nuk mund të lë pa përmendur edhe mungesën e orientimit në fakultete, veçanërisht për studentët e vitit të parë, të cilëve iu duhet të përballen edhe me ulërimat e sekretareve.

Si e kemi konstatuar se shumë prej studentëve nuk janë në degët që dëshirojnë?

Shumë studentë nuk janë në degët që dëshirojnë, jo vetëm këtë vit, por edhe vitin e kaluar, pra mund të themi se që është një "bixhoz" i madh me fatet, dëshirat e ëndrrat e rinisë studentore të këtij vendi. Sistemi i regjistrimit në arsimin e lartë dështoi dhe dëshmoi se nuk ishte sistem i meritës apo preferencës, pasi shumë studentë duke mos pasur siguri, u regjistruan shpejt e shpejt nga frika e paniku. Pas një anketimi, që ne kemi zhvilluar për vitin akademik 2016-2017, pyetjes, nëse janë regjistruar ose jo në presion në raundin e dytë e më pas, 65% kanë pohuar se janë regjistruar në ndikimin e presionit. Ndërsa pyetjes se si e vlerësoni në tërësi formulën e regjistrimit mbli 68% e studentëve e cilësojnë formulën e re si të keqe ose shumë të keqe.

Si paraqitet marrëdhënia student-pedagog?

Marrëdhënia student-pedagog është një marrëdhënie autoritare. Univer-



siteti publik ka dy lloj rrymash, nga njëra anë ka pedagogë të përgatitur, të ndershëm që i japin shumë rëndësi formimit të mëtejshëm intelektual të studentëve. Por, nga ana tjetër shumë pedagogë janë "tregtarë" që shesin librat e tyre me imponim, çmimet e të cilave në shumë raste janë tepër të larta. Shumë pedagogë burokratë kanë një marrëdhënie poshtëruese ndaj studentëve dhe përpigjen ta konvertojnë në para çdo gërmë që kanë shkruar në tekstin e tyre. Dija që marrim ne studentët në auditore është shumë e thatë, shumë burokratike, dhe nuk mund të krijojë admirim ndaj figurës së atyre pedagogëve që nuk japin shembuj solidariteti.

A ka pasur rritje të tarifave?

Shumë pedagogë janë "tregtarë" që shesin librat e tyre me imponim, çmimet e të cilëve në shumë raste janë tepër të larta. Shumë pedagogë burokratë kanë një marrëdhënie poshtëruese ndaj studentëve dhe përpigjen ta konvertojnë në para çdo gërmë që kanë shkruar në tekstin e tyre.

Në 2014-ën ka pasur rritje të tarifave, por jo fort e ndjeshme për shkak të protestave të shumta të studentëve. Por pavarësisht kësaj, tarifat e masterit janë shumë të larta për t'u përballuar. Edhe tarifat aktuale të nivelit Bachelor janë të larta e ne jetojmë në një vend ku 30% e popullsisë me zor po blejnë ushqimet, jo më të paguajnë tarifat e universitetit. Bursat e shkollimit janë të pamjaftueshme, pasi bursa e plotë është 80 mijë lekë dhe gjysmë-bursa 40 mijë lekë të vjetra.

Cilat janë disa nga problemet e studentëve jashtë universitetit?

Problemet janë edhe jashtë universitetit pasi është vënë re një rritje e çmimit të apartamenteve me qira që studentët jetojnë, kështu detyrohen të jetojnë në periferi, ta ndajnë edhe me shumë persona të tjerë dhomën. Shpesh mjediset ku jetojnë studentët ngjajnë me kampe refugjatësh. Ne, studentët jetojmë në një qytet që dita-ditës po pasurohet duke varfëruar njerëzit e thjeshtë. Shumë prej nesh janë të detyruar të punojnë që në vit të parë për të përballuar jetesën.

Çfarë i mungon sot universitetit?

Universitetit sot i mungon humanizimi, pasi para se të nxjerrë një profesionist, mbi të gjitha duhet të përgatisë një qytetar të mirë. Por nuk ia ka arritur për shkak të paafetësisë së burokratëve dhe djesh konformiste e teknike që na servitet e që na shndërron në robotë. Universiteti sot ka një mungesë aktivitetesh e stimuljsh ndaj studentëve që t'i motivojë për të studiuar e për t'u bërë dikush në jetë.

Përse e kundërshton lëvizja juaj ligjin e arsimit të lartë?

Një pikë e rëndësishme që ne e kundërshtojmë është zhvlefësimi i votës studentore, pasi vota e një pedagogu është e barasvlershme me votën e 50 studentëve për të zgjedhur drejtuesit e fakultetit përkatës. Qeveria po e braktis financiarisht universitetin e ky i fundit, i prirur për të gjetur para, po humbet autonominë. Ne jemi kundër këtij ligji pasi është formuar në mënyrë okulte nga burokratë të universitetit publik, nuk ka pasur një proces transparent. Askush nuk ka marrë mendimin e pedagogëve, apo studentëve se cila do ishte zgjidhja më e volitshme për problematikat, para hartimit të ligjit. Ky është një ligj klientelist që ne do e kundërshtojmë gjithmonë.



"INTEGRATED ENERGY B.V. SPV" shpk

FTESË PËR SHPREHJE INTERESI

Qeveria shqiptare, përmes një tenderi të hapur ndërkombëtar, ka shpallur fitues kompaninë "INTEGRATED ENERGY B.V. SPV" shpk me objekt dhënien me koncesion të formes BOOT (Build, Own, Operate dhe Transfer) për ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitim i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje koncesionare është menaxhimi i integruar i mbetjeve në Qarkun e Tiranës. Zona e propozuar për ndërtimin e impiantit të ri të MNU-ve dhe venddepozitimt do të shtrihet në jug dhe lindje të zonës së venddepozitimt ekzistues (Sharre) të qytetit të Tiranës.

"INTEGRATED ENERGY B.V. SPV" Sh.P.K (ne cilësie e koncesionarit) , fton kompanitë e interesuara vendese dhe të huaja të paraqesin kërkesën për shprehje interesi per fazën e parakualifikimit në procedurën konkurruese për zgjedhëse (Shërbime Konsulence) për shërbim mbikqyrje (Supervizim), për punimet e ndërtimit në zbatim të kontratës koncesionare me objekt "Për ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitim i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike"

DOKUMENTAT E KËRKUARA PËR FAZËN E PARAKUALIFIKIMIT

- Kërkesa për shprehje interesi e kandidati
- CV të kompanisë
- Ekstrakt i lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.
- Licençe profesionale për "Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi", e vlefshme, ku te perfshihen kategoritë të cilat lidhen me punimet objekt i kontratës koncesionare, (sipas modelit të lëshuar nga MPPT)
- Përvojë e suksesshme në projekte të ngjashme, në 5 vitet e fundit. Sfondi i kompanisë në aktivitetet të ngjashme si supervizimi dhe kolaudimi i landfilleve, iceneratorëve etj do të konsiderohet si të favorshme në vlerësim.
- Xhironja mesatare e tre viteve të fundit (definuar si futurim për punët në progres dhe të përfunduara) te jete jo me i vogel se Euro 250,000 (dyqind e pesëdhjetë) mijë.
- Bilancet e dy viteve të fundit.
- Certifikatat e cilësisë së kompanisë (ISO)
- Tabela e organizimit të shoqërisë (organizograma)
- Personeli kryesor i propozuar për këtë projekt (i paraqitur në formë organigrame) si dhe kualifikimet e stafit kryesor të propozuar.

"INTEGRATED ENERGY B.V. SPV" Sh.P.K, do të shqyrtojë dokumentat e dorëzuara nga Kandidatët, dhe do të vlerësojë nëse ky dokumentacion plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentat e paraqitura nga kandidatët. Kandidatët, që i plotësojnë kriteret e kualifikimit, do të njoftohen për të paraqitur propozimin teknik dhe propozimi ekonomik.

Kompanitë e interesuara duhet të dorëzojnë kërkesën origjinale dhe dokumentacionin përkatës, të futur në një zarf jo transparent, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e kandidatiit.

Paraqitja e kërkesave për shprehje interesi duhet të bëhet brenda datës : 27.10.2017 ora 16:00 në adresën e email: info@iebv.al

Asnjë ofertë e paraqitur pas këtij afati nuk do të pranohet.

"INTEGRATED ENERGY B.V. SPV" Sh.P.K
Adresa: Rr. Dervish Hima, Hyrja Nr. 1, Apartamenti 71/1
Të dhëna të kontaktit cel. 0688014284 , info@iebv.al

Personi i kontaktit : Zj. Denisa Tollkuçi
Email: info@iebv.al

Organizata Botërore e Shëndetësisë: 100 mijë doza në dispozicion

Vaksinimi, kategoritë më të riskuara nga gripi

Fushata, ja kush përfiton falas

Voltiza Duro

Më ardhjen e sezonit të sëmundjeve gri-pale, ka nisur ditën e djeshme fushata e vaksinimit ndaj gripit në spitalin e mushkërive, "Shefqet Ndroqi". Rreth 100 mijë doza vak-sinash antigrip janë vënë në dispozicion të popullatës, të cilat janë parakualifikuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Shefja e Departamentit të Kontrollit të Sëmundjeve Infektive të ISHP, dr. Silva Bino bëri thirrje për vaksinim të popullatës në risk, veçanërisht fëmijët, gratë shtatzëna dhe të moshuarit me sëmundje kronike. Sipas saj, vaksina ndaj gripit është e nevojshme, pasi ul ndjeshëm komplikacionet. Fushata e vaksinimit u çel



Mjekë duke u vaksinuar, gjatë ceremonisë së nisjes së fushatës së vaksinimit ndaj gripit, në spitalin e Mushkërive

pikërisht në atë spital, i cili një vit më parë ka përballuar një numër shumë të lartë të pacientëve me komplikacione të rënda të kësaj sëmundjeje virale. Kjo është një nismë e Ministrisë së Shëndetësisë, nëpërmjet Institutit të Shëndetit Publik, në bashkëpunim me OBSH. Vaksinim falas do të ofrohet për personelin shëndetësor

në mbarë vendin, gratë shtatzëna si dhe për kategorinë më të riskuar për komplikacione nga gripi, që do të sigurohen nga MSHMS. "Për herë të parë, fushata fillon në tetor në kohën e duhur për të qenë efektive për gripin stinor, në mënyrë që të minimizohen komplikacionet", - tha zv/ministria e Shëndetësisë, Mira Rakacolli gjatë

aktivitetit. Ndërsa, përfaqësuesja e zyrës së OBSH në Shqipëri, Nazira Artykova shprehu mbështetjen e OBSH për procesin e vaksinimit për kategoritë më të rrezikuara në Shqipëri. Muaji tetor shënon fillimin e sezonit të gripit dhe Institutit i Shëndetit Publik po punon me qëllim sensibilizimin e opinionit publik që të vaksinohen për të parandaluar sëmundjen. Gripi është një sëmundje infektive virale, e cila paraqitet në formë të lehta, por në raste të veçanta mund të shkaktojë forma të rënda dhe komplikacione që mund të çojnë deri në vdekje. Në Shqipëri që prej 2014-ës ofrohet një program vaksinimi për punonjësit e shëndetësisë, pasi këta të fundit janë ndër personat që preken më shpesh nga kjo sëmundje infektive virale.

Pas raportimit, autiku piktor pranohet në Lice

Nëna: Faleminderit "Gazeta Shqiptare"!

Disa ditë më parë, "Gazeta Shqiptare" publikoi historinë e Drinit, autiku "gjeni" në pikturë, i cili nuk pranohej në Liceun Artistik të Tiranës. Por fill pas raportimit, ka ardhur një përgjigje pozitive që i ndryshoi jetën e i riktheu buzëqeshjen, tashmë 19-vjeçari është nxënës i kësaj shkolle. Nëna e tij, Edlira Sallaku falënderon "GSH" për rolin e madh që pati në sensibilizimin e opinionit publik e instancave përkatese, që reagon pas publikimit të shkrimit. "Dua të falënderoj pa masë "Gazetën Shqiptare", që paraqiti problematikën e tim biri me vërtetësi dhe në mënyrën më të mirë të mundshme. Vetëm një ditë pas daljes së shkrimit, më telefonuan dhe më thanë që ka dalë urdhri nga MAS për regjistrimin e Drinit në Lice", - thotë Edlira. Gjithashtu, ajo i shpreh mirënjohjen dhe falënderimet e saj edhe ministres së Arsimit, Lindita Nikolla për urdhëresën e zbatimit në formë absolute për regjistrimin e Drinit në shkollë, si dhe Gramoz Ruçin për ndihmën që ofroi. "Tim biri i është rikthyer buzëqeshja, madje dje po qeshte e po kërcente me nxënësit e tjerë. Tashmë Drini mund të jetojë i lumtur", - shprehet nëna e 19-vjeçarit.

Përurohet "Avioni", vepra më e re e artit në njësinë 7 në kryeqytet

"Avioni" është vepra më e re e artit e ideuar nga Eljan Tanini, që i është shtuar ish-Fushës së Aviacionit në Njësinë 7 në kryeqytet. Kryebashkiaku Erion Veliaj falënderoi autorin e veprës artistike dhe theksoi se ajo rikthen në kujtesën e shumë të rinjve sot një nga ëndrrat e bashkëmoshatarëve të tyre në kohën e regjimit të shkuar: "Dua t'i falënderoj me gjithë zemër për kontributin fantastik, të gjithë ata që kanë dhënë një dorë, që kanë sponsorizuar realizimin e veprës. Vërtet kemi pasur kushte më modeste, ndoshta kemi qenë më të lumtur, se kemi pasur një komunitet më të fortë", - tha Veliaj. Por, përveç vlerës kulturore edhe estetike që kjo veper i jep të gjithë zonës, ai theksoi se ajo do të shërbejë edhe si një mënyrë për ta kthyer këtë hapësirë në një vend të preferuar për zhvillimin e aktiviteteve artistike dhe edukative, kryesisht për të rinjtë. Ndërsa, autori i kësaj vepre, Eljan Tanini, theksoi se ky krijim është një dhuratë për fëmijët e kryeqytetit.



Implemented by giz

Programme: Customer and Performance Oriented Drinking Water and Sanitation Services

The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) is a federal enterprise that supports the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation for sustainable development. The water programme CPWS assists Albania to provide affordable water supply and sewerage services to its population with an orientation at EU standards. In particular support is planned to the following four areas:

1. implementation and further development of the water sector re-structuring
2. efficient and sustainable services by water and sewerage utilities
3. effective water sector regulation
4. increased performance orientation, accountability and involvement of consumers

At local level the programme supports three partner municipalities and their water utilities in the improvement of drinking water and sanitation services, especially performance orientation, accountability and in customer orientation. For the support of the GIZ expert team, GIZ Office Albania is looking for a

Advisor hydro-engineer

with focus on water supply and sanitation.

A. Responsibilities

Assistance to the GIZ expert team particularly but not only on the local level for the municipalities and their water utilities to improve drinking water supply and sanitation services.

Assistance to advisory services shall be rendered on technical development of water services in a participatory manner with water utility staff:

- To advise the water utilities on appropriate implementation of the water utilities' service mandate (urban/rural) to improve the company's core processes, like production, delivery, energy efficiency, O&M, effluent quality control
- Advice on implementing water safety plans
- Advice on health and safety plans for water utility staff
- Assistance in training (on-the-job)
- Advice on improvement of data quality
- Advice on sampling and quick analysis of drinking water and effluents

B. Tasks

The Hydro-engineer performs the following tasks:

- Participating in identifying needs for external support and advice for the water utilities
- Follow-up of project progress and activities in close cooperation with the partners
- Contributing to the preparation of technical reports and to the annual reports for the programme manager
- Assists in the preparation of terms of reference, selection, and supervision of contracted third parties in carrying out project/programme's activities, including performance evaluation and impact monitoring
- Assistance in preparation and implementation of workshops, seminars, and other events on subjects that are related to the programme's/project's field of activities
- Advises the AV on acquisition potential and modes for closer collaboration among development partners

Communication and networking

- Co-operates with and ensures regular contacts and dialogues with project partners, as well as with other projects in Albania in order to enhance and maintain good working relationships
- Communicates and channels local interests and exchanges ideas and information for the benefit of the programme
- Maintains repeated field visits to the project intervention area in accordance with the requirements of the project

Knowledge management

- Assist in improving the programme's knowledge management system and tapping into other knowledge management systems
- Compiles information about ongoing programme activities and ensures knowledge transfer
- Prepares reports and presentation materials
- Prepares appropriate input to the various project/programme reports/publications including annual reports; contributes to other reports required by the Programme Manager and GIZ Headquarters.

Management and Coordination tasks

- Assists the programme team in the general project planning
- Assists in the coordination and prioritisation of relevant project activities in cooperation with the partners, as well as in organizational preparation and implementation of these activities

Required qualifications, competences and experience:

- Masters/bachelor degree in civil engineering (Hydro technical engineering) or related fields or extended professional working experience
- At least 2 years of work experience in a relevant area
- Ability to support a multi-task, multi-discipline programme team
- Fluency in written and spoken English, German language would be an asset
- Able to work in a team as well as independently
- Excellent social and communications skills

Contract conditions:


- Full-time employment
- Programme office in Tirana
- Frequent travelling within Albania (particularly to the three partner municipalities Cerrik, Peqin and Himara)
- Assignment period 01/2018 -09/2019

Please forward your application until 31st of October, to GIZ Office Albania by E-Mail:

giz-albanien-hr@giz.de including the following information: Application letter, CV in English (Europass format), references.

Only short-listed candidates will be contacted for interviews. Short-listed candidates will be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!



Aeroplani i ri prej letre

E ardhmja
është emocionuese.

Ready?



BOTIMI/STUDIMI



"Shoku Stalin i quajti shkrimtarët tanë "inxhinierë të shpirttrave". Çfarë do të thotë kjo? Çfarë detyre ju ngarkon ky titull?"

Botimi i fundit i Galerisë Kombëtare të Arteve, me titullin "Realizmi socialist shqiptar - studim mbi fenomenin bazuar kryesisht në koleksionin e Galerisë Kombëtare të Arteve", me autor Dr. Ermir Hoxha është një katalog i ndërtuar mbi artin në periudhën e Realizmit socialist, me ndarjet historike respektive, dhe e gjitha shoqëruar nga një studim i gjatë mbi fenomenin. Përveç tij, në tekstin shoqëruar trajtohen nëntemat tipike të Realizmit socialist shqiptar, si: Historia nëpërmjet imazheve, Kulturi i individit - Imazhi i Enver Hoxhës në artin pamor, Njeriu i ri, Stereotipet, Standardet dhe morali, Uniteti Ushtri-Popull si dhe Një vëzhgim krahasimor, mbi huazime tipike në tema e kompozime. Me 256 faqe, 40 faqe studim i ilustruar, dhe një katalog ku gjejnë hapësirë 151 artistë me 315 imazhe, ky botim hap një dritare të re përfaqëse ndaj krijimtarisë artistike të njërës prej periudhave më rëndësishme të artit vendas e njëkohësisht më të vështira.

Në hyrje të studimit autori shpreh se: "Arti i Realizmit socialist, zhvilluar në Shqipëri në komunizëm gjatë Luftës së Ftohtë, në një vështrim të parë, ishte një art euforik, optimist e i bukur. Si pjesë e platformës shtetërore, ai ishte imazhi zyrtar i ideologjisë komuniste, prej fundit të viteve 1950 deri në përmbytnjen e regjimit në vitin 1991. Si i tillë, në thelb ai do të predikonte një Botë të Re, që ngrihej mbi gërmadhat e asaj të vjetrës; një Botë të Re pa shfrytëzim, shfrytëzues e të shfrytëzuar, ku nuk ekzistojnë klasa sociale e ku të ardhurat ndahen tek të gjithë në mënyrë të barabartë. I ndërtuar si një metodë estetike, Realizmi Socialist, sot mbetet dëshmia materiale, e prekshme, e një ëndrrë të pamaterializuar dhe vizioni artistik i një Bote tjetër, ardhja e së cilës është ende thuasje e pamundur."


KATALOGU

Historia e tij zyrtare sot është e njohur. Ajo nis fill pas Revolucionit të Tetorit (1917), më saktë me ardhjen e Stalinit në pushtet, kur Shoqata e Artistëve Revolucionarë Rusë, e themeluar në maj të vitit 1922, mbështeti përfaqësimin realiste përkundërjt avangardave. Më 1934, në Kongresin e I-rë të Shkrimtarëve Sovjetikë, Andrei Zhdanov propozoi Realizmin Socialist, si artin e vetëm zyrtar, duke iu drejtuar pjesëmarrësve: "Shoku Stalin i quajti shkrimtarët tanë "in-

KATALOGU I REALIZMIT SOCIALIST

Nga kulti i individit te mega-propaganda

Me 256 faqe, 40 faqe studim i ilustruar, dhe një katalog ku gjejnë hapësirë 151 artistë me 315 imazhe



Në foto: Koperina e librit

vërteta dhe karakteri historik konkret i prezantimit artistik, duhet t'i bashkëngjitet detyrës së transformimit ideologjik dhe edukimit të punëtorëve në frymën e socializmit. Kjo metodë e letërsisë dhe kritikës është ajo që ne e quajmë metoda e Realizmit Socialist." Mbi origjinën e tij, kritikuro Boris Groys shpreh se: "Realizmi socialist nuk u krijua nga masat, por u formua në emër të tyre nga njerëz të mirëarsimuar dhe elita të specializuara, të cilët, pasi asimiluan eksperiencën e avangardave, ofruan Realizmin socialist me logjikën e brendshme të metodës të avangardave, e cila nuk kishite aspak lidhje me kërkesat dhe shijet e masave."

"Inxhinierët e shpirttrave", shkrimtarët, piktorët, skulptorët, kineastët e artistët e cilitdo format, u ngarkuan me detyrën e transformimit ideologjik dhe "ushqimin shpirtëror të masave". Ata duhet të krijojnë për shtetin, me formën dhe mjetet që ai i gjykonte si më të përshtatshmet; ndërsa i gjithë ky transformim ideologjik, në formë realiste (të kuptueshme) tekta i drej-



tohej proletariati, duhej ta ndërtonte veten mbi formë e tema të përcaktuara. Në kongresin e vitit 1934, shteti nga artistët kërkonte që arti të ishte: 1. Proletar - një art që i drejtohej punëtorit dhe ishte i kuptueshëm prej tij; 2. Tipik - shkëlqim nga jeta e përditshme e popullit; 3. Realist - në paraqitjen e imazhit; 4. Partizan - mbështetës i orientimeve dhe qëllimeve të shtetit dhe partisë.

Në artin pamor, e gjithë kjo de-shifrohet lehtësisht në tema, si: Portreti i Udhëheqësit, →

ARTAN SHABANI: PËR TË KUPTUAR NJË NGA PERIUDHAT E TRASHËGIMISË KULTURORE



Në foto: Artan Shabani


Një prej investimeve më domethënëse në këtë fushë do të ishte ngritja e Galerisë Kombëtare të Arteve, inauguruar në vitin 1974 në bulevardin kryesor të kryeqytetit. Ky ishte sinjali kulmor që arti shqiptar ishte shkëputur tërësisht nga e shkuara e tablove të vogla, me temë intime nga bota e brendshme e artistit, për një art militant, në përmasa të mëdha, triumfues e optimist, në

linjë me revolucionarizimin e jetës në çdo sektor. Realizmi socialist Shqiptar sot, në esencën e vet, përbën pjesën më të rëndësishme të arkivit të fondit të GKA.

Si një rrymë dominante për dekada me radhë, ai u braktis, u demonizua, u shënjestrua për të keq, u mohua dhe u degradua gjatë zhvillimeve të fund-viteve 1980 dhe gjatë gjithë dekadës 1990 - 2000. Por më pas, gradualisht, qëndrimi ndaj tij erdhi drejt një rikalibrimi historik dhe estetik, dhe sot studimi dhe rrugëtimi i këtij fenomeni arti totalitar në 4 dekada, përbën një nga sfidat kryesore studimore të arteve pamore në Shqipëri. Duke qenë se raporti i tij me pushtetin dredhohet përshtatet sipas shijes e direktivave të udhëheqësit, si dhe lu-

hatjeve të mëdha e të ashpra të politikës vendase, studimi i tij, parë në rrafsh global, kthehet sot në një detyrë imperative për të kuptuar lidhjet mes artit dhe politikës.

Për periudhën është shkruar jo pak, por akoma jo në mënyrë shteruese. Realizmi i këtij katalogu të rëndësishëm për periudhën, ndërtuar mbi analizën e disa prej medimeve më të rëndësishme ku ai u përqendrua, është një nga ofertat më domethënëse të këtij institucioni për të kuptuar mirë një nga periudhat më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore të vendit tonë. Shoqëruar dhe me një tekst të gjatë studimor mbi fenomenin, temat e stereotipet mbi të cilin ai u ndërtua, ky katalog sot përbën një nga ftesat më të mira për një dialog real me të shkuarën e afërme të vendit tonë.



← Njeriu i Ri, Tabloja Historike, Jeta Socialiste apo Peizazhi Industrial. Këto tema, u materializuan në mijëra e mijëra tablo, postera e monumente, në vëzhgimin e rreptë të makinës së propagandës, në gjithë vendet e orbitës sovjetike. Kuptohet që këto terma, kushtëzuan krijimtarinë e lirë artistike, ndërsa metoda realiste e paraqitjes së imazhit, u ngarkua me forcë nga ideologjizimi i skajshëm, si një seri veprash ilustrative publicitare, duke prekur shpesh kufijtë e groteskut.

Igor Golomstock, një nga studiuesit më të rëndësishëm të Realizmit Socialist, ofron një këndvështrim personal të strukturës shtetërore totalitare, duke e përcaktuar atë si një mega-makinë: një strukturë e formuar nga elementë njerëzorë të gjallë, të ndrydhur apo karizmatikë, ku secili kishte një rol të përcaktuar qartë, e cila me një organizim masiv të detyruar, bën të mundur realizimin e projekteve madhështore. Kjo mega-makinë, është epiqendra dhe shtylla mbajtëse e një regjimi totalitar, pa të cilën, asnjë udhëheqës nuk do kishte qenë në gjendje të ndërtonte mitin (kultin e individit) dhe besimin e patundur në popull për kundrejt figurës së tij.

Lewis Mumford, një tjetër studiues i rëndësishëm i këtij fenomeni, shpjegon se struktura e mega-makinës mund të vihej në punë me besim të verbër të popullit drejt udhëheqësit, nëpërmjet një enturazhi burokratësh, që merrreshin me ndarjen dhe organizimin e punës, duke mobilizuar masa të stërmëdha njerëzish dhe materiale, për realizimin e veprave publike e private që garantonin funk-


sionimin, konsolidimin dhe zgjerimin e vetë pushtetit. Kjo strukturë, koordinimi i elementëve të së cilës bënte të mundur funksionimin e vetë strukturës totalitare, ishte e ngjashme dhe shpesh e njëjtë për gjithë regjimet e këtij lloji. Kështu u angazhuan edhe artistët, shkrimtarët e kineastët, të cilët u përcaktuan si ingranazhe të rëndësishëm, që nën orientime të përpikta, duhet të fuqizonin megamakinën për të arritur qëllimin: dominimin absolut të vetëdijes dhe vullnetit të individit. Në artin pamor, "ikonografia" kërkohet në trajtë realiste, si mjeti më i mirë për konsumin masiv duke e transformuar kështu "Realizmin", në një stil internacional dhe në produktin e natyrshëm të totalitarizmit. Aparati shtetëror kontrollonte, orientonte dhe eliminonte gjithë ndërhyrjet stilistike apo ikonografike që paraqisnin ndryshime strukturore nga kanonet e kërkuara, gjë që mbështetej nga një politikë persekutimi dhe represioni të drejtpërdrejtë mbi

jetën dhe veprimtarinë e krijuesve.
ATA QË NUK U PËRSHTATËN

Shumë artistë, fajtorë për një

mospërshtatje me "teknikën" apo për devijimin nga "linja" e udhëzuar, konsideroheshin si devijatorë dhe si të tillë, ju refuzohej e drejta e ushtrimit të profesionit, përndiqeshin ose "riktheheshin" pranë gjirit të klasës punëtore, për të rikërkuar e rigjetur frymëzimin te punëtorët dhe njerëzit e thjeshtë. Shumë të tjerë, vuajtën nga xhelozia e pushtetmbajtësve, apo ranë viktimë të fushatave të ndryshme të represionit që ndërmerre shteti, duke përfunduar në burgje apo kampe internimi.

Materializuesit e Realizmit Socialist, shkrimtarët, arkitektët, kineastët, piktorët e kështu me radhë, kishin për detyrë të ndiqnin apo ndërtonin stereotipat dhe klishejt. Me gjuhën e artit, ata mundoheshin të krijojnë një të vërtetë të re, që në sytë e popullit paraqitej thjesht subjektive, por që në tërësi, justifikohet me kërkesën për të krijuar një ideal për jetën dhe njeriun e ri. Me një entuziazëm lehtësisht të konstatueshëm, si të ndriçuar nga një diell personal, personazhet e tyre jetojnë në realitet paralel, një "parajsë socialiste" ku zhduket si me magji lodhja e varfëria, kampet e internimit, agjentët e Sigurimit dhe spiunët e shpërdarë kudo. Të gjithë ata zhduken, sepse në parajsën socialiste, vendet janë zënë nga heronjtë e kohëve të reja; janë zënë nga heronjtë triumfatorë, nga kooperativistët, mësuesit, minatorët e inxhinierët, janë zënë nga punëtorët (ndërtuesit e socializmit), apo ushtarët (mbrojtësit e tij). Në të vërtetë kjo "parajsë tokësore" nuk jetohej, përveç se si imazh, shpërndarë në çdo centimetër teksa merr për sipër të ilustrojë realitetin socialist. Si në një skenë gjigande, në



të personazhet qeshin e qeshin pafund, si në një garë lumturie, përtej të mundshmes, përtej të imagjinueshmes.

TABLOTE

Tablotë e realitetit socialist, edhe pse në shumicën e rasteve të vështira për t'u besuar dhe nga vetë artistët, propozoheshin, në mos si ekzagjerim i realitetit, të paktën si e ardhme e afërt e tij. Pra, një ideal i asaj që kërkohet, që ndoshta nuk kishte ardhur në formën e plotë, por që padyshim ishte aty pranë, pasi në optikën e mega-makinës, arti ofron jo vetëm atë që duhet të shohësh, por edhe atë që duhet të besosh. "Kompozimi i imazheve ezaurohet në vështirimin dhe aplikimin drejt kategorisë së besimit: Besoj atë që shoh. Ajo që më tregohet është e vërteta, më autentike se ajo që më shpallet para syve çdo ditë në jetën e përditshme."

Në tablotë e jetës së përditshme, fatlumët që jetojnë realitetin socialist, dorkojnë në tavolina plot e përplot, gëzojnë apartamente të modës, pushojnë në shtëpi pushimi e shëtisin të lumtur në fusha pjellore. Kjo pesë socializmi, tashmë për ta, është një realitet i prekshëm. Është realiteti për të cilin dje luftuan me armë dhe sot e shijojnë në të gjitha sferat e veta. Është ai realitet që solli revolucionin komunist, me modernizimin e jetës, emancipimin e shoqërisë dhe industrializimin e ekonomisë. Është faza kul-

more e të gjitha sakrificave. Është ajo fazë, kur më në fund proletariati mund të gëzojë frytet e një revolucioni të kryer. Është faza e shijimit të triumfit, pas përmbyesjes së shfrytëzuesve, rindarjes së pasurisë, luftës mbi mbeturinat e së kaluarës, industrializimit dhe ndërtimit të socializmit. Sipas Pirettos, ajo konsiston në "transfigurimin e karaktereve thjeshtësisht funksionale, duke iu mundësuar atyre të veshin domethënie specifike simbolike e kulturore, mbi të gjitha, një aureolë joshëse."

PARAJSA SOCIALISTE

Parajsa socialiste, ky vizion imagjinar, ishte në thelb thjesht zëvendësues i vizionit ekzistencial, predikuar nga religjioni. Në ngjashmëri faktike, ideologjia totalitare tentuan të zëvendësojnë fenë dhe lidhjen e saj shpirtërore me popullin. Elementët e saj kryesorë, konceptimi e simbolet identifikuese, riti dhe premtimi i jetës së përgjeshme, zëvendësohen nga ideologjia me simbolet përkatëse, riti (puna) dhe premtimi i parajsës (kësaj radhe tokësore). Si në njërin a në tjetrin version, bashkë me to, funksion parësor, shihet të ketë dhe arti, si ilustrues i "tokës së premtuar". Parajsa në versionin socialist pasqyrohet në tablotë nga "jeta e përditshme", brenda familjes, në kampe pushimi, në festa dhe vende pune. E ngjashme me shumë me një reklamë, ajo ndryshon brenda kampit socialist nga vendi në vend, duke u përshtatur me terrenin që gjen, ndërsa në thelb ajo përbën përmbyesjen e "profecisë" marksiste, që në qëllimin e saj final kërkonte ndryshimin e rendit shoqëror. Në këto tablo, Njeriu i Ri, tashmë i materializuar, jeton. Ai është ngado, entuziast, pasi "parajsa tokësore" e premtuar, tashmë është bërë realitet dhe "dora e grohtë" e partisë-shtet, edhe kur nuk shihet, ndjehet thjesht e kundododhur.



Një vit më parë u nda fizikisht nga familja, të afërmit, miqtë, kolegët dhe ish-studentët e shumë profesori akademik Alfred Uçi. Me krenari pohoj se një ndër mijëra studentët që profesor Uçi u ka përcjellë leksione ndër vite kam qenë edhe unë. Ndohëse ka lënë si trashëgimi të vyer një korpus të madh veprash që trajtojnë me shkallën më të epërme të cilësive shkencore probleme të estetikës e të folklorit, të filozofisë e të sociologjisë etj., mungesa fizike e profesor Uçit ndjehet shumë jo vetëm ndër të afërmit, por edhe ndër të njohurit e tij të shumtë. Fare-fare pak intelektualë shqiptarë kanë pasur dhe kanë personalitet me fuqi rrezatuese aq të madhe sa profesor Alfred Uçi në shumëca: në parashtrimin e vizioneve më të gjera, më të argumentuara holistikisht për zgjidhjen e çështjeve më të mëdha e më të ndërlikuara në rrafsh kombëtar dhe më gjerë, në reflektimet krejt origjinale për zgjidhjen edhe të problemeve të zakonshme të jetës së përditshme, në konstruktimin e kuotave më të larta të dinjitetit njerëzor, në gjenerimin e energjive kundër çdo veshi e dukurie negative në jetën shoqërore, në formulimet elegante, krejt origjinale të urimeve dhe të ngushëllimeve për gëzime e hidhërimi të jetës së përditshme, në informacionin e gjerë, të konservuar me saktësi matematikë në harddiskun aq të pasur të kujtesës së tij të jashtëzakonshme etj. Ai mund të krahasohet me një googël të gjallë, që funksiononte me shtëpësi maksimale për të ofruar në fraksione të sekondës atë që i kërkoje përmes pyetjeve.

Përgjithësisht dijetarët që zotërojnë një fond shumë të pasur të njohurive, të informacioneve të shumëllojshme e kanë përgjithësisht të ngadalshëm procesin e të menduarit dhe të artikulimit të përgjigjeve. Ndërsa me profesor Uçin ndodhte e kundërta. Për çdo pyetje që i bëje ai të jepte në çast përgjigjen më të plotë, më të argumentuar. Nga takimet që kam pasur fat të kem me profesor Uçin më është krijuar bindja se në veprën e tij të shumëvëllimshme, enciklopedike e shkencërisht shumë të argumentuar ai nuk ka materializuar as gjysmën e njohurive dhe të informacioneve që zotëron, sidomos për zhvillimet komplekse, shpesh kontradiktore të shoqërisë shqiptare që nga fillimet e Rilindjes Kombëtare deri në ditët tona. Personaliteti i profesor Alfred Uçit u formata me kuotatime të epërme në shumëca falë jo vetëm trashëgimisë familjare intelektuale e atdhetare (ka qenë nip nga nëna i heroit të martirizuar për zhvillimin e shkollave shqipe dhe për çlirimin kombëtar prej Perandorisë Osmane, Petro Nini Luarasi); por edhe i angazhimit të tij tërësor në të gjithë përjekjet e popullit shqiptar për liri (në moshën 13-14 vjeçare ka qenë partizan me armë në dorë në luftë për çlirimin e Shqipërisë nga pushtuesit fashistoz-nazistë përgjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore) dhe për përparim arsimor-shkencor dhe të gjithanshëm. Ai u formata duke qëndruar gjithnjë në ballë të frontit për përballimin e sfidave të shumanshme si rrallëkush në hapësirën shqiptare dhe më gjerë.

1. Në dallgë e sfidave

Në fillim të viteve '90 të shekullit XX, kur shoqëria shqiptare përjetoi kthesën e kalimit nga sistemi socialist totalitar në rrjedhën e zhvillimeve demokratike, profesor Alfred Uçi ishte në prag të moshës zyrtare të pensionimit. Ndërkohë ishte filozofi dhe esteti më i afirmuar në hapësirën shqiptare. Kishte botuar 9 tekste e punime monografike, në të cilat trajtohehin me përparësi probleme të estetikës, çështje teorike të artit, të krijimtarisë folklorike etj., pa llogaritur shkrime studimore të botuara në organet e shtypit në hapësirën shqiptare dhe në disa vende të tjera si dhe bashkautorësitë në hartimin e disa teksteve të filozofisë për studentët e nxënësit e shkollës së mesme.

Sociologët amerikanë, që kanë trajtuar me përparësi problematikën sociale të kërkimit shkencor, si Merton Allison, Steart etj., kanë argumentuar se në përvjetorin e tyre të gjashtëdhjetë shumica e shkencëtarëve janë të ngurtësuar, sidomos lidhur me pranimin e të vërtetave të reja, duke i bërë kësajsoj ata frenues për progresin. Sipas këtyre sociologëve, vetëm një numër fare i vogël shkencëtarësh më të aftë, më produktivë bëhen edhe më produktive me kalimin e moshës. Profesor Alfred Uçi i përket kësaj elite më elitare të studiuesve.

Ndërkohë që mjaft kolegë të tij, studiues në fushën e filozofisë, të arteve e të estetikës, madje edhe më të rinj në moshë, nuk i përballuan sfidat e kthesës, si të thuash, u tërhoqën nga fronti i vështirë i kërkimit, profesor Alfred Uçi gjatë 26 vjetëve të fundit të zhvillimeve demokratike (1991-1996) ka shkruar dhe ka botuar literaturë shkencorë të standardeve akademike më të arrira, më shumë se dyfishi i asaj që kishte botuar para vitit 1990.

Krijimtaria shkencore e profesor Alfred Uçi është polivalente. Ajo ndriçon teorikisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë e të tërthortë, vartësisht nga rrethanat social-kulturore, edhe çështjet më të ndërlikuara të zhvillimeve filozofike, estetike dhe përgjithësisht kulturo-logjike në rrafshin universal dhe kombëtar.

2. Kritikë profesionale - drejtare kah modernitetin

Duke pasur formatin e plotë të shkencëtarit profesionist të klasi të parë, profesor Alfred Uçi është karakterizuar nga shpirti kundërkonformist, çka e ka mbrojtur në një masë të madhe krijimtarinë e tij nga dogmatizimi ideopolitik që imponon strukturat përkatëse të regjimit socialist totalitar. Me vizionin e profesionistit me kualifikimin më të lartë shkencor, profesor Alfred Uçi edhe në kushtet e diktaturës së proletariatit (deri në vitin 1990) i ka shfrytëzuar të gjithë hapësirat e mundshme për të përcuruar në mjedisin e dogmatizuar të shoqërisë shqiptare teoritë e doktrinën filozofike, estetike e kulturo-logjike, të cilat nuk kishin "pasaportë" hyrjeje në shoqërinë shqiptare të vetizuar shkajshëm. Kritika e doktrinave të tilla ishte e vetmja frëngji nëpërmjet së cilës ata mund të depërtonin në bunkerin e diktaturës komuniste në Shqipëri. Dhe

ALFRED UÇI

Personaliteti më i arrirë i dijetarit që na mungon

Nga prof.dr. Zyhdi DERVISHI



Profesor Alfred Uçi

profesor Alfred Uçi, me shumë mundime dhe duke riskuar jo pak, ka qenë gjithnjë në ballë të përpjekjeve për të çelur dhe zgjeruar një frëngji të tillë drejt një bote të hapur, për ta mbajtur atë gjithnjë në gjendje funksionimi. Veçanërisht teksti në tri vëllime "Estetika" (1987-1988) dhe punimi monografik "Labirintet e modernizimit" u kanë ofruar studentëve, kritikëve, specialistëve të shkencave shoqërore e artistike dhe publikut të gjerë një tablo të gjerë të doktrinave filozofiko-estetike, të cilat nga strukturat ideologjike zyrtare të regjimit socialist totalitar konsiderohehin "idealiste, reaksionare", "borgjezë dekadente", "revizioniste" etj. Këta libra janë shkruar me një logjikë e stil të tillë që funksionojnë natyrshëm si kritika, por në radhë të parë dhe me përparësi si parashtrim i argumentuar qartë i doktrinave kryesore estetike e të ndërthurjeve të tyre me doktrinën filozofiko-sociale, kulturo-logjike etj. Sidomos gjatë viteve 70 e 80 të shekullit XX studentët e degës së filozofisë, të letërsisë, të arteve, artistë të të gjithë profileve komunikimin me rrymat kryesore bashkëkohore të mendimit estetik, artistik, kritik etj., kryesisht nëpërmjet librave dhe artikujve të shumtë të profesor Alfred Uçit. Për studentët ai ka qenë gjithnjë pedagogu model, i niveleve superiore në aftësitë pedagogjike e shkencore, në dinjitetin shkencor e shoqëror; përherë i përkushtuar ndaj mësimdhënies dhe kërkimit, gjithnjë kundërshtar i paepur i perversitetit të kohës në rrafsh politik e social, profesional e moral etj.

3. Profile teorike të estetikës

Është e vështirë, ose më saktësisht e pamundur që në formatin e një shkrimi të ravijëzohen tiparet e arritjet më të spikatura të veprimtarisë shkencore të profesor Alfred Uçit. Megjithatë do të përpiqemi të rilevojim vetëm disa prej tyre, të trupëzuara në vepra të botuara vitet e fundit.

Së pari, duke qenë njohës i thellë i kulturave, i qytetërimeve kryesore, i ligjësisë të zhvillimit të tyre, profesor Uçi i shyrton doktrinën filozofike, estetike e artistike të kontekstualizuara në rrjedhën e zhvillimeve shoqërore, kulturore, artistike etj. Në veprat e tij gërhohehen natyrshëm argumentimet e përgjithësimve të nivelit më të lartë me analizat ilustruese të dukurive konkrete estetike e artistike në shoqëri e kohë të ndryshme.

Së dyti, të gjitha doktrinën filozofike, estetike artistike analizohe në rrjedhën e evolucionit të tyre, në dinamikën e ndryshimit të funksioneve të tyre social-kulturore, në procesin e përditësimit dhe të ndikimit të tyre në zhvillimet e ardhshme. Për këtë ai, ndër të tjera argumenton: "Gjatë zhvillimit historik të filozofisë formulohen ide e probleme filozofike, rëndësia e të cilëve kuptohet më thellë në sfond të bashkëkohësive dhe zhvillimit të ardhshëm të dijeve. Dhe kjo do të thotë se historia e filozofisë rrëhim në të kaluarën për t'i shërbyer zhvillimit bashkëkohor dhe së ardhmes; ajo është një disiplinë që përtëritet e pasurohet, duke i shëmbëllyer asaj qenies mitike. Janusit me dy fytyra: njëra e drejtuar prapa dhe tjetra drejt kohës sonë".

Së treti, ndonëse kultura shqiptare ka shtrirje gjeografike të kufizuara, autori në gjithë krijimtarinë e tij ka evidentuar komunikimet e kulturave të përhapura në hapësira më të gjera me kulturën shqiptare në rrafshin filozofik, estetik, artistik etj. Arritjet e mendimit filozofik, estetik, artistik etj. qarkullojnë nga njëra kulturë në tjetrën dhe anasjelltas, duke synuar vazhdimisht lartësimin e mendimit shkencor, saktësimin e tij përmes diskutimeve gjithnjë më intensive etj.

Së katërti, edhe në fushën e kërkimeve shkencore, sidomos për problematikën sociale, kulturore, artistike, filozofike etj., jo pak personalitet të shquara nuk u kanë shpëtuar kurtheve të paragjykimëve të shumëllojshme, trajtimeve të njëanshme etj. Profesor Uçi i ka kapërcyer gjithnjë me sukses kurthe të tilla. Në veprat e tij spikat një përmasë universalizuese, citohen e analizohen pikëpamjet më me vlerë të autorëve të vendeve perëndimorë dhe të atyre lindorë, si grekë e gjermanë, amerikanë e rusë, italianë e polakë etj. Ai e qëmon nektarin e formulimeve teorike kudo ku gjendet, jashtë mjegullonës së paragjykimëve, e cila pas Luftës së Dytë Botërore, veçanërisht në vendin tonë, ka mbuluar herë hemisferën perëndimore e herë atë lindore. Për të ilustruar këtë ide mjafton të përmendim se vetëm në 5 faqe të vëllimit të dytë të librit "Universiteti estetik" citohen 12 nga filozofët, estetët dhe teoricienët më të shquar të arteve të vendeve dhe të epokave të ndryshme nga antikiteti deri në ditët tona si Aristoteli e Plotini, Agostini e Akuini, Isidori e Prokopi, Bedai e Kroce, Shastleri e Bayeri, Xhiliberti dhe Kuni. Edhe përzgjedhja e citaveve dëshmon se autori i këtij libri njih deri në imësi jo vetëm tërë sistemin e pikëpamjeve të mendimtarëve që i referohet, por edhe veçoritë e dinamikës së evolu-

cionit të indit të mendimit filozofik dhe estetik nga njëri tek tjetri edhe nën ndikimin e rrethanave social-kulturore në proces ndryshimi.

4. Përgjithësimi teorik me rrezatim përtej kulturës shqiptare

Po të shpreheshim me terminologjinë e sociologut amerikan bashkëkohës Robert K. Merton, profesor Alfred Uçi në gjithë veprimtarinë e tij kërkimore-shkencore udhëhiqet nga "ideali shkencor i skepticizmit të organizuar". Duke parë tërë historinë e mendimit filozofik, estetik e kritikë-artistik me thjerrëzat e një skepticizmi të tillë, profesor Alfred Uçi vë në dyshim, madje i hedh poshtë me argumentime të plota edhe paragjykimet pothuajse të fosilizuara, të cilat kanë penguar përparimin e mendimit filozofiko-estetik edhe në vendet më të shquara të Perëndimit. Edhe esteti e studiues mjaft të urbuar, si Kroce, Xhiliberti, Kun, Shastleri etj., në forma të ndryshme e kanë nënvëlësuar mendimin estetik mesjetar ose e kanë mohuar fare atë. Për shembull, Shastleri mbron idenë se "Një miqë vjetër e mesjetës janë thjesht një zbrazësi për sa i përket mendimit estetik". Profesor Alfred Uçi jo vetëm argumenton themelësisht e pikëpamjeve të tilla, por parashtron një tablo të plotë analitike të vlerave të doktrinave estetike të përpunuara gjatë mesjetës, të cilat përbëjnë një fazë të rëndësishme përparimi, një hallkë të domosdoshme ndërlihe ndërmjet universitetit estetik të antikitetit dhe begatisë së mendimit estetik të periudhës moderne. Lidhur me këtë çështje në vëllimin e dytë të librit "Universiteti estetik" profesor Uçi thekson: "... një nga problemet kyçe të analizës sonë do të jetë raporti midis universiteve estetikë të antikitetit dhe të mesjetës, dallimet cilësore dhe lidhjet ndërmjet tyre, kontinuiteti e diskontinuiteti, vazhdimësia e bijezimit dhe ndarjet midis tyre".

I ndriçuar nga një metodologji e saktë shkencore, profesor Alfred Uçi depërton në të gjithë labirintet e mendimit estetik, të cilat përshkojnë epokat historike nga Antikiteti, Mesjeta, Rilindja dhe Klasicizmi. Nëpërmjet analizash komplekse shumëpërmasore ai arsyeton jo vetëm arritjet e mangësitë e çdo doktrine estetike në sfondin kohor të zhvillimeve shoqërore, filozofike e shkencore, por edhe parashtron sipas kriterave antologjike fragmentet më përfaqësues të çdo doktrine. Kësajsoj, librat e profesor Alfred Uçit shpërfaqen si mozaikë shumë të larmishëm, me një pasuri të pallogaritshme mendimesh të nuancuara, pohimesh e kundërshtimesh, argumentesh e kundërgjyqimesh, faktesh artistike e historike etj. Por autori asnjëherë nuk humbet në këto labirinte falë aftësisë së tij përgjithësimore të jashtëzakonshme: "Në vazhdim e veprimit të faktorëve social-kulturore - nënvizon ai në vëllimin e dytë të "Universiteti estetik", - por edhe të faktorëve estetiko-artistikë imanentë për 15 shekuj, që na interesonin në librin tonë, mund ta përcaktonim si substancë kryesore të kristalizuar dhe të zhvilluar klasicizmin (klasikën), i cili kuptohet prej nesh si një koncentrat i ideve më konsistente, më genësore estetike e artistike, që ka ardhur edhe përmes përvetësimit të trashëgimisë pozitive të antikitetit e të mesjetës dhe ka evoluar drejt klasicizmit të shek. XVII, që shënon një ekspansion të përgjithshëm edhe të kulturës estetiko-artistike në përgjithësi. Por kjo s'do të thotë se përmbajta e çdo epoke ka qenë krejt monolite, se në secilin prej tyre spikat një bërthamë e tipit klasik, por krahas saj kanë ekzistuar edhe risi e anësime të tjera, herë të nxitura nga hapësirat e lira të klasicizmit, herë nga kundërshtimi i kufijve disi të ngurtë të absolutizimit të kësaj bërthame". Ky është një karakteristik përgjithësues i nivelit të lartë i klasikes si një koncept qendror i historisë së zhvillimit të shoqërisë e të filozofisë, të estetikës e të arteve.

5. Përkthimi - një ndihmë për integrimin e kulturës kombëtare

Që kur ka përfunduar studimet universitare deri sa mbylli sytë përgjithnjë, për afro 62 vjet, profesor Alfred Uçi ka qenë në ballë të veprimtarisë kërkimore. Mjaft nga tekstet, artikujt dhe sidomos punimet monografike të shumta kanë vlera jo vetëm në hapësirat e kulturës shqiptare, por dhe më gjerë. Ndaj mendojmë se është obligim i strukturave shkencore të shtetit shqiptar të financojë përkthimin e botimin në gjuhë të huaja, së paku në anglisht, të studimeve më të arrira të akademikut Alfred Uçi, veçanërisht ato që kanë profil kombëtar më të spikatur ose që përfaqësojnë arritje për mendimin filozofiko-estetik në shkallë botërore. Me shumë se respekt për akademikun Alfred Uçi përkthime të tilla do të ishin nderim për kulturën shqiptare filozofiko-estetike, për afrimin e saj me kulturën europiane e më gjerë, për integrimin e kulturës shqiptare në rrjedhat e zhvillimeve botërore bashkëkohore.

Në vendet me traditë të zhvilluara universitare e shkencore dijetarëve të shquar, veçanërisht vitet e fundit të jetës, u atashohen asistentët të kualifikuar që i ndihmojnë për të përballuar aspektet teknike të kërkimit dhe sidomos për t'i vjelë mendimet që për arsye moshe ata nuk mund t'i pasqyrojnë në libra e botime të tjera. Mendimi të tilla kanë rëndësi të veçantë për vjëmësinë dhe zhvillimin me ritme të shpejtë të disiplinave shkencore. Në mungesë të një asistenti të tillë, fatkeqësisht, profesor Alfred Uçi iku nga kjo botë duke marrë me vete shumë informacione dhe sidomos ide, të cilat ai i kishte selitur me punë sistematike, intensive në rrjedhën e shumë viteve. Kjo rrethanë e bëu edhe më të hidhur humbjen nga largimi i tij. Megjithatë, duke iu referuar një perfrazimi nga Bibla mund të themi se duhet të ndjejmë të privilegjuar se patëm fatin që e kishim profesor Alfred Uçin, këtë personalitet të papërsëritshëm të shkencave filozofike e albanologjike, këtë model më të arrirë të dinjitetit të njeriut e të shkencëtarit.

Lista emërore në Shkodër, Malësi e Madhe dhe Pukë. Kompensimi fizik e financiar, në rend kronologjik

ATP, statusi i secilës pronë në Shkodër

Emrat e pronarëve, sipërfaqja e pretenduar dhe sa kompensohet

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtimit të Pronës ka përditësuar regjistrin e saj elektronik për dosjet e pronave në të gjithë vendin. Çdo trashëgimtar pronash ka mundësi të lexojë në "Gazetën Shqiptare" statusin e dosjes së tij dhe problematikën e dokumenteve që mund të ketë secili pronar. Regjistri elektronik mban të

dhëna të detajuara për çdo aplikim dhe çdo proces që ka ndodhur me pronat që nga viti 1993 dhe deri tani për qarkun e Shkodër. Secila nga dosjet përmban emrin e subjektit të shpronësuar si dhe emrin e subjekteve që e pretendojnë atë pronë. Në dosje pasqyrohen sipërfaqja e pretenduar si dhe lloji i pasurisë, sipërfaqja e njohur, sipërfaqja e kthyer apo e kompensuar. Ndërkohë që pasqyrohen edhe të gjitha vendimet e Komisioneve dhe Zyrave Rajo-

nale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për secilin subjekt, bashkë me vendimet gjyqësore dhe problematikat e secilës dosje. "Gazeta Shqiptare" nis sot publikimin e listës së veprimeve që janë kryer me dosjet e pronave të qarkut të Shkodër. Të gjithë të interesuarit njihen gjithashtu edhe me problematikat që mund të ketë dosja e tyre, siç është mungesa e dokumenteve të caktuara. Ndërkohë, Agjencia e Tra-

jtitimit të Pronave ka marrë në shqyrtim dosjet në qarkun e Elbasanit, të cilat janë në proces shqyrtimi. Regjistri i dosjeve në shqyrtim pasqyron numrin e dosjes, emrin e subjektit të shpronësuar, kërkuar, llojin e pasurisë si dhe të dhënat në lidhje me sipërfaqen e njohur, sipërfaqen e kthyer dhe sipërfaqen e kompensuar. Në regjister janë edhe të dhënat për çdo dosje për vendimet e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si dhe pro-

blematika që ka çdo dosje, e cila pasqyron mangësinë në dokumentacion. Sot publikohet regjistri elektronik i pronave në qarkun e Shkodër, ku përfshihen Shkodra, Malësia e Madhe dhe Puka. Dosjet ndodhen në Agjencinë e Trajtimit të Pronave në proces shqyrtimi dhe do të trajtohen me ligjin e ri. Vendimi do të merret sipas rendit kronologjik të kërkesave dhe kompensimi do të shpërndahet sipas këtij rendi, me përjashtim të rasteve

kur subjekti kërkon të përfutojë nga pagesa e përshpejtuar, ose kërkon të jetë pjesë e tenderit për kompensimin fizik në bazë të pronave që kanë në dispozicion ATP-ja. ATP-ja do t'i japë përparësi kompensimit të truallit. Kompensimi për ish-pronarët për tokën truall, sipas zërit kadastral të vitit 1945 dhe hartës së vlerës së tokës që është në fuqi do të kryhet me para. Kufiri i caktuar nga ligji është 50 milionë lekë për çdo vendim të njohur.

LISTA E VEPRIMEVE QË JANË KRYER ME DOSJET E PRONAVE TË QARKUT TË SHKODRËS (PJESA E PESËMBËDHJETË)

(Vijon nga numri i djeshëm)

Emri (Subjekti i shpronësuar)	Mbiemri (Subjekti i shpronësuar)	Emri (Subjekti Kërkuar)	Mbiemri (Subjekti Kërkuar)	Sip. E pretenduar, m2 & lloji i pasurisë	Zona Kadastrale	NR I Vendimit I KKKP, ZRKKP	Sip. E Njohur/ Mosnjohur e M2	Sip. E Kompensuar M2	Problematika
Cuk	Simoni(Tushi)	Trashg. Simoni		5000m2 truall	Rrenc / 3168	424	5000		
Gjergj	Gocaj	Gjergj	Gocaj	2000m2 truall	Obot / 2819	423	2000	2000	I eshte njohur e drejta e komp. Per 2000m2 me arsyetimi n qe ky truall esht trajtuar si fushe bujq. Dhe si e tille eshte ndarre me 7501
Ernest	Gocaj	Ernest	Gocaj	1600m2 truall	Obot / 2819	422	1600	1600	I eshte njohur e drejta e komp. Per 1600m2 me arsyetimi n qe ky truall esht trajtuar si fushe bujq. Dhe si e tille eshte ndarre me 7501
Ymer	Hoti	Vjoleta	Hoti	12000m2 truall	Bardhaj / 1105	421	5000	5000	Pronesia vertetohe t nga Vertetimi I pronesise leshuar nga Keshilli I Rrethit Shkoder
Jak	Brungaj	Jak	Brungaj	1500m2 truall	Obot / 2819	419	1500	1500	
Mark	Simoni	Trashg. Shkoza		500m2 truall	Qyrsac	418	500	500	Pronesia vertetohe t nga Vertetimi I pronesise leshuar nga Keshilli I Rrethit Shkoder
Taip	Zeneli	Taip	Zeneli	15000m2 truall	Oblike / 2817	417	10000	10000	Pronesia vertetohe t nga Vertetimi I pronesise leshuar nga Keshilli I Rrethit Shkoder
Selo	Abdullahi	Trashg. Thaci		1200m2 truall	Pacram / 2851	416	1200	1200	
Gjergj	Nika	Trashg. Nikaj		4700m2 truall	Qyrsac	415	4710		Pronesia vertetohe t nga Vertetimi I pronesise leshuar nga Keshilli I Rrethit Shkoder
Mark	Lorenci	Licije	Lorenci	S1=500m2 truall S1=800m2 truall	Hajmel / 1920	414	1000	500	Pronesia vertetohe t nga Vertetimi I pronesise leshuar nga Keshilli I Rrethit Shkoder
Zef	Vjerdha	Gjon	Vjerdha	3000m2 truall	Pistull / 2975	413	3000	3000	Pronesia vertetohe t nga Vertetimi I pronesise leshuar nga Keshilli I Rrethit Shkoder

Mark	Lumci	Viktor	Lumci	1500m2 truall	Pistull / 2975	412	1500	1500	Pronesia vertetohe t nga Vertetimi i pronesise leshuar nga Keshilli i Rrethit Shkoder
Jonuz	Cungu	Trashg. Cungu		12500m2 truall	Dobrac / 1495	411	10250	1750	
Isuf	Tahiri(Per eseku)	Trashg. Perseku		1500m2 truall	Mjede / 2702	410	1500	650	
Shtjefen	(Luka)	Trashg. Luka		8000m2 truall	Rranxa / 3205	409	8000		
Gjeto	Shmarqi	Trashg. Shmarqe		6800m2 truall	Drishiti / 1545	408	6800		
Ded	(Bicaj)	Trashg. Bicaj		400m2 truall	Mazrek / 2624	407	400	400	Pronesia vertetohe t nga Vertetimi i pronesise leshuar nga Keshilli i Rrethit Shkoder
Shtjefen	Molla	Trashg. Molla		17500m2 truall	Hajmel / 1920	406	10750	10750	Pronesia vertetohe t nga Vertetimi i pronesise leshuar nga Keshilli i Rrethit Shkoder
Shuke	Vasia	Ferit,Saba hete,Myz afere,Vjol lca dhe Hiqmet	Vasia	12600m2 truall	Dajc / 1435	405	10260	6260	Pronesia vertetohe t nga Vertetimi i pronesise leshuar nga Keshilli i Rrethit Shkoder
Gac	Xhanaj(Tu shi)	Trashg. Tushi		S1=300m 2 truall S1=6000 m2 truall	Barbullus h / 1100	404	6300	6300	Pronesia vertetohe t nga Vertetimi i pronesise leshuar nga Keshilli i Rrethit Shkoder
Nik	Guri	Zef	Nika	3000m2 truall	Palaj / 2859	403	3000	3000	
Gjon	Ashiku	Trashg. Ashiku		9800m2 truall	Gur i Zi / 1989	402	9800	9800	
Keshillat Xhamive		Keshillat e Xhamive Kuc e Vukatane		S=100m2 S=1000m 2 S=5000m 2 S=1000m 2 S=2000m 2 Xhamia Vukatane	Vukatane / 3838	400	4700		Pronesia vertetohe t nga Vertetimi i pronesise leshuar nga Keshilli i Rrethit Shkoder
				S=125 dy t. are S=5 dy kullote Xhamia Kuc					
Keshillat Xhamive				S=4000m 2 Ganjolle		401	14200		Pronesia vertetohe t nga Vertetimi i pronesise leshuar nga Keshilli i Rrethit Shkoder
Mark; Gjon; Rrok	Krroqi	Trashg. Krroqi		S=9500m 2	Trush / 3652	459	9500		Pronesia vertetohe t nga Vertetimi i pronesise leshuar nga Zyra e Ipotekes Shkoder
Emin	Kalaja	Latif	Kalaja	S=14750 m2	Barbullus h / 1100	458	7480		Pronesia vertetohe t nga Vertetimi i pronesise leshuar nga Keshilli i Rrethit Shkoder
Zef	Gjergji	Trashg. Gjergji		S=10000 m2	Hajmel / 1920	457	3600	3600	Pronesia vertetohe t nga Vertetimi i pronesise leshuar nga Keshilli i Rrethit Shkoder
Ethem		Trashg. Barbullus hi		S=8000m 2	Zues / 3949	456	8000		Pronesia vertetohe t nga Vertetimi i pronesise leshuar nga Keshilli i Rrethit Shkoder
Rustem	Uraj	Trashg. Uraj		S=21700 m2	Mes / 2665	455	11170		
Ded	Lulgjuraj	Ndrek	Gjinaj	S=5000m 2	Grude e Re / 1869	454	5000	5000	
Ded	Berisha	Age	Berisha	S=5000m 2	Grude e Re / 1869	453	5000	5000	
Brahim	Micojani	Zenel	Micojani	S=550m2	Bushat / 1329	452	550	550	Pronesia vertetohe t nga Vertetimi i pronesise leshuar nga Keshilli i Rrethit Shkoder
Lush	Ejlli	Nush	Gocaj	S=12.5 dy	Darragjat / 1448	451	1000	1000	
Tahir,Seli m,Xhevde t	Myrtja	Tahir	Myrtja	S=1500m 2	Babot / 1065	450	1500	1500	
Pjeter	Gjoni	Pjeter	Gjoni	S=2000m 2	Obot / 2819	449	2000	2000	
Pjeter	Shuku	Pjeter	Shuku	S=5000m 2	Rrenc / 3168	448	1500		
Sait	Mehaj	Haxhi	Mehaj	S=6300m 2 e tjetersuar ne truall	Trush / 3652	447	6300		
Man	Sylja	Trash. Zalli		S=8000m 2 e tjetersuar ne truall	Golem / 1790	446	6500		
Rrok / Gjon	Preka	David	Preka	S=9300m 2 e tjetersuar ne truall	Hot I ri / 1965	445	9300		
Hajdar ; Maje	Rexhepi	Trash. Hajdari,Di bra dhe Halluni		S=3600m 2 truall	Dobrac / 1495	444	3600		


Opinion i Ditës

Piramida Maslow e qeverisë

Nga Dr. Sorina Koti*


(Vijon nga faqja e parë)

... në fushën politike. Së fundmi, është përshtatur për fushën e biznesit, por unë mora guximin ta përfroj dhe ta ndërtoj për nevojat e qeverisjes dhe fushës politike. Më poshtë është piramida, e cila mund të analizohet për aktualitetin ku ndodhet qeverisja shqiptare dhe pritshmëritë e qytetarëve ndaj qeverive dhe politikanëve.



© Sorina Koti

Nëse i referohemi Piramidës Maslow në kontekstin qeveritar, mund të themi se shteti dhe qeveritë shqiptare janë ende në përbushje të Nivelit 1. Siguria për stabilitet të institucioneve dhe administratës publike na nxjerr në pah nevojën dhe rëndësinë, që kanë burimet njerëzore. Burimet njerëzore janë baza për funksionimin e institucioneve për përbushjen e qëllimeve për të cilat qeveria është krijuar. Problemi i trashëguar në Shqipëri është militantizmi i administratës publike, pasiguria për vendin e punës kur ndërrohen forcat politike, mungesa e motivimit, specializimit të nëpunësve dhe investimeve në administratë. Ende



nëpunësit publikë kalojnë nëpër ferrin politik, ku në çdo hap ndëjnë presionin e tij. Gjithashtu, problem kryesor mbetet edhe problem profesionalizmi i administratës, ku jo gjithmonë shohim njerëz të shkolluar, që punojnë në profilin e tyre. Kjo mungesë sjell ngërc funksional, i cili ka shkakuar rritje të korrupsionit, duke filluar që në nivelin më të ulët të administratës

deri në majë të saj. Nëse nuk zgjidhet ineffiçenca e administratës, atëherë kjo na e rrëzon të gjithë piramidën e sistemit funksional të qeverisë.

Niveli 2, Qeverisja dhe reformat, nënkupton që qeveritë ndër vite hartojnë reforma, por pjesa më e madhe e tyre ngelet në letër ose zbatohen pjesërisht. Pothuajse asnjë reformë e rëndësishme nuk është

hartuar dhe zbatuar e plotë, duke lënë hapësira për përmirësim, diskutim, abuzim dhe nevojë urgjente për ndryshim. Mosrealizimi i reformave dhe mungesa e efikasitetit të tyre shkakton ngërc politik-ekonomik, si dhe le në ngërc investimet e huaja dhe ato të brendshme.

Niveli 3 lidhet me prezencën e shtetit dhe ndjesitë, që kanë qytetarët kundrejt saj. Në Sh-

qipëri prezenca është pothuajse e papërfillshme dhe ndjehet më shumë me anën e barrës fiskale, kontrollet dhe presionet, rryshfet, sesa për të qenë partner me biznesin dhe të sigurojë qytetarët me nevojat bazike (shëndetësi, arsim, rend-siguri, ushqim-strehim, drejtësi).

Niveli 4, Respekti dhe vlerësimi i qytetarëve ndaj qeverisë dhe punës së saj mbetet në nivele të ulëta. Sondazhet tregojnë se besimi dhe reputacioni lë për të dëshiruar edhe në rastet kur qeveritë kanë arritje. Kjo vjen si rezultat i zhgënjimeve të vazhdueshme, të cilat vijnë nga premtimet elektorale të pakryera ndër vite. Ky nivel konsiderohet shumë i rëndësishëm për qeveritë dhe politikanët, pasi kjo tregon nivelin dhe numrin e ndjekësve si dhe fitimet e mandateve qeverisëse.

Niveli 5, Morali, kreativiteti dhe zgjidhja e problemeve është niveli më i lartë, që kërkon një qeveri të arrijë. Për fat të keq, në Shqipëri të tria elementet e nivelit 5 janë të papërbushura dhe larg pritshmëri, që ka qytetari për modelin e politikanit shqiptar. A kemi zgjidhje të problemeve në Shqipëri? Ende jo!

Akoma pas 27 vitesh, në programet politike ka ende premtime bazike si ato për drita dhe ujë 24 orë, shëndetësi dhe arsim falas, siguri dhe shërbime. Në Shqipëri vuajmë nga sindroma e politikanëve-qeveritarë të pasur me popull të varfër. Realiteti shqiptar është shumë ndryshe nga ajo që promovohet. Gjithçka është një premtim në letër, ku nuk punohet për të siguruar nevojat bazike të popullsisë. Përditë e më shumë reagimi qytetar po kthehet në një zë të mbytur!

* Drejtore ekzekutive
"Economic Intelligence Center"

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ



Opinion *i* Ditës

Nënë Tereza më ndihmoi të gjej Shqipërinë dhe parajsën

Nga Jose Pinto *

(Vijon nga faqja e parë)

... e Bashkuara Arabe dhe në shumë të tjera, kurrë nuk kam reshtur së dëgjuari dhe së frymëzuar nga Nënë Tereza, ikona shqiptare e bamirësisë dhe mirësisë me famë ndërkombëtare. Në jetën time nuk ka pasur ditë që nuk kam menduar se sa gjigante ishte vepra e saj.

Unë kam lindur në Madeira, ishulli i pranverës së përhershme, siç quhet ndryshe, nga dy prindër që fort besuan në veprat e mira që rrjedhin si rezultat i besimit në Zot. Kështu, kur dëgjova për Nënë Terezën, isha kaq i lumtur që usheja dashurinë time të vazhdueshme për këtë grua, që mori vëmendjen e gjithë botës me personalitetin e saj magjepsës dhe u bë burim frymëzimi për të gjithë brezat.

Nënë Tereza më ndihmoi të mësoja më tepër rreth Shqipërisë nga distanca, por koha erdhi që të shkelja në këtë vend. Minutën e parë që vura këmbën në këtë vend, të gjitha mendimet e mia rreth Shqipërisë, të perceptuara nëpërmjet figurës së kësaj gruaje të madhe, dolën të vërteta. Menjëherë kuptova se sa e bekuar është toka shqiptare dhe sa të bukur janë shqiptarët. Buzëqeshja e tyre, mirësia e tyre, mikpritja e tyre unike më bënë për vete sapo erdha në aeroportin ndërkombëtar të quajtur sipas emrit të saj, "Nënë Tereza". Çfarë rastësie e përkryer!

E mbaj mend si dje, megjithëse tri vite kanë kaluar tashmë, ditën që po vija për në Shqipëri. Në avion takova dy të rinj që po udhëtonin nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës për në Shqipëri për të takuar gjyshërit e tyre. Ndjeva menjëherë miqësinë dhe mikpritjen shqiptare. Ata filluan të flisnin me ngrohësi dhe edukatë dhe me kaq shumë zemër sa që nuk isha ndërjerë kurrë kështu më parë.

Pasi më pyetën nëse kjo ishte hera ime e parë në Shqipëri, ata më treguan vendet që duhej të vizitoja, ushqimet që duhej të shikoja, ndërsa flisnin pa pushim për Berat, Gjirokastrën, Butrintin dhe vende të tjera brenda kësaj bote cudirash që më mori zemrën.

Më tej, oficerja e emigracionit në aeroport personifikoi më së miri mikpritjen shqiptare tek mu drejtua: "Mirë se vini në Aeroportin 'Nënë Tereza', z. Hose!". Thashë me vete "Çfarë surprize! Sepse shumë nga oficerët e emigracionit i bien shkurt me fytyrat e tyre serioze. Më pas, ajo më pyeti nëse kjo ishte vizita ime e parë në Shqipëri. Ju përgjigja: "Jo vizita e parë, por minuta e parë në këtë vend madamë".

"Uau! - u përgjigj ajo duke shtuar me krenari - Mirë se vini në vendin tonë, ju uroj ta kaloni sa më mirë, shihemi përsëri!".



Këta janë njerëzit e tokës shqiptare, të bekuar nga Nënë Tereza. Nuk ka faqe mjaftueshëm për të shkruar për këta njerëz dhe për ikonën e tyre ndërkombëtare - Nënë Tereza.

Si Hose, unë kam një filozofi, e fituar nga kjo Zonjë e Pavdekshme, të cilën e përdor në jetën dhe punën time të përditshme. Jeta është një rrugë, e cila hapet si me magji nga çdo njeri, i cili ka një pastërti shpirtërore dhe karakterizohet nga integriteti dhe vlerat. Për njerëz të tillë, kjo rrugë zgjerohet,

pengesat gjatë saj zhduken, ndërsa pemët në djaja anët e saj të buzëqeshin. Përse kështu, do të mendoni ju?

Sepse të nxjerrësh në pah njeriun, i cili ka kontribuar për njerëzimin është diçka që edhe vetë Perëndia e miraton dhe e ndihmon. Dhe ky njeri, i njohur nga njerëzimi dhe Perëndia nuk njih moshë.

Disa mund të thonë se njerëz të tillë ju gjithnjë fitojnë. Përsëri më vjen në mendje shprehja e Nënë Terezës "Vazhdo të bësh mirë edhe nëse të kanë lënduar" dhe "Nëse je

siqertë dhe i ndershtëm, njerëzit mund të mashtrojnë. Pavarësisht nga kjo, vazhdo të jesh i sinqertë dhe i ndershtëm".

Ashtu si shumë vargje janë shkruar në muret e shtëpive të femijëve të Nënë Terezës në Kalkuta në Indi. Apo shumë shprehjeje të tjera, që më bëjnë të mendoj çdo ditë si "Mos u shqetëso kurrë nga mendimet e të tjerëve, mendo se të gjithë ne mund të bëjmë gjëra të mëdha" apo "Ne mund të bëjmë gjëra të vogla me shumë dashuri".

*J.P Hospitality Co.

HOROSKOPI

DASHI

Të kënaqur me surprizat e dhuruara nga Jupiteri, që bashkëvepron me Uranin do të jeni shumë aktiv. Sot me të vërtetë do t'ia kaloni bukur. Do të keni dëshirë t'i përkushtoheni studimit të lëndëve të reja, mbi të gjitha preferoni shkencën dhe matematikën.

DEMI

Merrni pak kohë për t'u menduar mbi mundësitë e reja profesionale, që ju janë ofruar. Më mirë të mos merrni vendime bazuar mbi entuziazmin momental. Nëse vazhdoni të mos ndiheni në lartësinë e duhur në disa situata, ashtu do të dalë me të vërtetë. Më shumë optimizim!

BINJAKET

Sot jeni të dashur, të shoqërueshëm dhe do të keni raporte më të mira me familjarët dhe miqtë. Falë Uranit që ju favorizon, do të tejkaloni vështirësitë që do t'ju dalin. Për ata që janë beqarë, priret të ketë një takim që do t'ju ngjallë emocione të mëdha.

GAFORJA

Plutoni parashikon vështirësi. Do të ndiheni nën trysni nga një sërë angazhimesh që do të keni. Do të shfaqen rivalitete dhe konkurrenca. Në familje priret shumë nga ju dhe kjo ju vendos në vështirësi, duke bërë që të mos jeni tolerant.

LUANI

Jupiteri që ju favorizon, bëhet 'zëdhënës' i lajmeve të mira, ftesa dhe risi të këndshme. Do të ndjeni emocione të këndshme të papërkrahueshme. Do të bëni disa ndryshime në shtëpi dhe gjithçka do të jetë edhe më e bukur se më parë.

VIRGJERESHA

Gjatë ditë së sotme nuk do të jeni në humor të mirë, do të kundërshtoni çdo gjë, por mos e ekzagjeroni! Do të jeni i tendosur dhe personi i zemrës do të vendosë t'ju shpërfillojë, duke ju lënë të vetëm të tejkalon shqetësimin që keni.

PESHORJA

Bashkëveprimi i Plutoni me Uranin do t'ju nxisë të shfrytëzoni sugjerimet që merrni dhe do t'ju shtyjë të shprehni krijimtarinë e juaj. Në dashuri do të përjetoni atë ndjesi intimiteti dhe përkatësie që ju emocionon e që ju dhuron qetësi.

AKREPI

Mos e lini t'ju ikë një mundësi e bukur takimi për shkak të bindjes se nuk u përshatani mjediseve të caktuara. Sigurisht që jeni i përshtatshëm, provojeni që ta besoni. Do të ropateni për të gjetur një ekuilibër midis lirisë vetjake dhe punës. Në fund do t'ia dini.

SHIGJETARI

Bashkimi i Hënës me Saturnin do të nxisë priren për t'u mbyllur në vetvete, duke mos shfaqur emocione dhe ndjenja. Sot jeni të shpërndërruar dhe nervozë, por për fat të mirë humorit i keq është i përkohshëm dhe dielli do të ndriçojë!

BRICJAPI

Ditën e sotme do të jeni autoritarë dhe konkretë. Gjithsesi, për shkak të kundërshtive të vogla do të përjetoni momente të mira e të këqija. Dorëzohuni përpara fakteve, zemra ju rreh fort për një person të veçantë, që deri më tani e keni shpërfillur.

UJORI

Së bashku me Uranin, Mërkuri premon mrekulli! Është qershia mbi tortë për ata që duhen të përballen me një detyrë të rëndësishme në punë apo një provim. Jeni i qartë në mendime dhe keni një vizion të qartë për të ardhmen. Juve i doni risitë.

PESHQI

Është dita e duhur për të kaluar momente të mira jashtë qytetit me miqtë. Dikush do t'ju bëjë të ëndërroni, do t'ju marrë përdore dhe do t'ju çojë një në vende të shpirtit, që nuk i keni njohur më parë. Kjo është mundësi e mirë për të gjetur personin e zemrës.

Kombëtarja Shqiptare e Futbollit do të luajë një ndeshje miqësore ndaj Turqisë më datë 13 nëntor. FSHF-ja ka njoftuar se është arritur marrëveshja mes dy federatave për takimin, i cili do të luhet në Antalja. Sipas Federatës Shqiptare të Futbollit, trajneri Kristian Panuçi ka kërkuar vetëm një ndeshje miqësore në muajin nëntor ndaj i vetmi kundërshtar do të jetë Turqia. "Duke iu përmbaj-



Panuçi kërkoj një ndeshje të vetme

FSHF zyrtarizon miqësoren me Turqinë më 13 nëntor

tur edhe kërkesave të trajnerit Kristian Panuçi për të pasur vetëm një ndeshje miqësore në këtë periudhë, u arrit edhe marrëveshja përkatëse. Tashmë mes dy federatave është gjetur akordi përfundimtar dhe zyrtarisht FSHF konfirmon zhvillimin e miqësore me skuadrën përfaqësuesen të

Turqisë. Trajneri Christian Panuçi do të grumbullojë ditë përpara skuadrën për përgatitjen e kësaj ndeshjeje miqësore, e cila do të jetë e vetmja për muajin nëntor. Shqipëria kthehet të luajë përsëri pas disa vitesh një miqësore me Kombëtarën e Turqisë. Ballafaqimet zyrtare me Turqinë i përkasin

vitit 2005, në eliminoret për Kampionatin Botëror", shkruan FSHF. Një kërkesë e çuditshme kjo e Panuçit duke qenë se çdo trajner dëshiron të ketë sa më shumë mundësi për të provuar lojtarët në kushte loje në mënyrë që të bëjë zgjedhjet më të sakta në takimet zyrtare.

Njëshi i stolit bardhekuq nuk i druhet Partizanit të Beogradit: Jemi rritur nga dy ndeshjet e para

Daja: Dua një dhuratë të bukur për ditëlindje

Pragmatizëm dhe cinizëm, trajneri ka gati taktikën



Jeton Selimi

Trajneri i Skënderbeut, Ilir Daja, ka bërë të ditur se objektivi i klubit mbetet vendi i dytë në grupin e Ligës së Europës, ndaj skuadra e tij do të bëjë gjithçka për të fituar kundër Partizanit të Beogradit në duelin e nesërm. Në konferencën për shtyp, ai konfirmoi edhe mungesat e rëndësishme dhe disa ndryshime në formacionin e skuadrës së tij. "Objektivi i klubit është kalimi i grupit dhe mendojmë se nëse duam ta realizojmë atë duhet të hyjmë nesër kundër Partizanit në fushë vetëm për fitore. Por duhet të jemi edhe të kujdesshëm për të shman-

gur aksionet në drejtim të veprimeve individuale pasi kundërshtari zotëron kontingjent me cilësi shumë të mira. Nuk jemi më pak edhe ne, sepse kemi cilësi brenda ekipit, lojtarët tanë kanë eksperiencën e duhur për të përballuar një kundërshtar të fortë si Partizani i Beogradit".

Për sa i takon taktikës së skuadrës së tij, Daja kërkon një ekip që të shfrytëzojë në maksimum rastet që do t'i paraqiten. "Duhet të jemi pragmatistë, por nëse duhet të shkojmë drejt fitores, pavarësisht koeficientit të vështirësisë, pasi përballë kemi një ekip me traditë,



duhet që pjesën më të madhe të lojës ta komandojmë ne që të mos i lëmë shumë

topin kundërshtarit pasi ka elemente, të cilët nga hiçi mund të ndërtojnë aksion me individualitete që mund të hapin probleme".

Ilir Daja pret shumë suport nga tifozët, ndërsa shpreson që të marrë një dhuratë të bukur për ditëlindje. "Ne kemi të gjithë kohën që përgatitemi për të shmangur tensionin. Është prezent tensioni i jashtëm të ekipi ynë, por duhet të fokusohemi vetëm te fusha e lojës. Veprimet tekniko-taktike, në mënyrë që edhe atë suport nga publiku që nuk do të na mungojë, ne t'ia

shpërblejmë në fushën e lojës. Duhet të përqendrohemi që të mbetemi të gjithë të kënaqur. Mbetet për t'u parë çfarë bëjnë futbollistët për të bërë ditëlindjen më të gëzuar".

Për ndryshimin në krahasim me dy takimet e mëparshme: "Janë dy ndeshje ndryshe nga njëra tjetra. Me Dinamon ka qenë një humbje e vëmendjes që solli shpërndarimin dhe humbjen. Në ndeshjen me Jang Bojs ishim shumë minuta në sulm, ndryshuam shtejt me dëmtimin e Gavazajt dhe na mungoi pastaj freskia. Kjo solli uljen e kondicionit të përgjithshëm. Mendoj se, nëse do të kishim lojtarët e dëmtuar, mund të kishim shkuar edhe drejt fitores me Jang Bojs. Secili ekip ka karakteristika e veta. Jang Bojs është ekip më i fortë në një aspekt, Partizani i Beogradit në një tjetër. Të dy janë ekipe të forta, rivalë duke parë klasifikimin pas dy ndeshjeve ku Dinamo e Kievit ka një hap më përpara dhe pikavarazhi bën të mundur të jemi rivalë dhe pretendojmë për një vend të dytë".

SITUATA NË SHKODËR



Largohet Cungu, Vllaznia transferohet në "Reshit Rusi"

Vllaznia i ka bërë një nisje jo të mirë kampionatit, teksa në gjashtë javë ka marrë vetëm pesë pikë, falë fitores së arritur me Lushnjën dhe barazimeve me Luftëtarin dhe Flamurtarin. Laçi, Teuta dhe Kamza e kanë mposhtur skuadrën shkodrane, ndërkohë që sfida e radhës luhet me Partizanin në "Loro Boriçi". Ditën e djeshme u zhvillua një analizë me kryebashkiaken Voltana Ademi, që shprehu hapur besimin e saj për stafin dhe lojtarët. Gjithsesi ka ardhur kthesa e madhe, pasi trajneri Armando Cungu ka dhënë dorëheqjen dhe ajo është pranuar. Tashmë pritet të zyrtarizohet trajneri i ri.

"LORO BORIÇI"

3 ndeshje brenda një jave kanë bërë dëm të madh në tapetin e stadiumit "Loro Boriçi" të Shkodrës. Bari është dëmtuar dhe tani duhet një ndërhyrje urgjente që ai të rregullohet. Nisur nga kjo, ndeshja e vlefshme për javën e shtatë të Superligës, ajo në mes Vllaznisë dhe Partizanit, mund të mos luhet në këtë stadium, shkruan "Shkodrasport". Pritet që duke nisur nga nesër, të nisë hedhja e një fare të re bari dhe kjo natyrisht që do të kërkojë kohë për të mbirë, çka e bën të pamundur luajtjen e ndeshjeve aty dhe, përveç sfidës me Partizanin, mund të humbet edhe ajo me Skënderbeun. Ndonëse ende nuk ka një vendim përfundimtar, ndeshjet mund të luhën në fushën sportive "Reshit Rusi". Vendimi do të merret sot, por gjasat janë që të ndodhë kështu.

Trajneri i Partizanit të Beogradit: Nuk mendoj për tension në stadium

Xhukiç: Dua fitoren, por kënaqem edhe me barazimin

Mirosllav Xhukiç pret një ndeshje të fortë të enjten në mbremje. Në konferencën e pasaçme për shtyp, trajneri i Partizanit të Beogradit deklaroi se e njeh mirë Skënderbeun dhe se vjen në këtë përballje për të marrë tre pikët. "Ndeshje shumë e vështirë. Skënderbeu është ekip agresiv, me sulm të fortë e mbrojtje solide. Tifozëria do t'i japë zemër Skënderbeut, ndaj edhe një barazim na kënaq, edhe pse natyrisht luajmë për fitore, ndaj një rivali direkt dhe shumë serioz, që ka eliminuar me meritë Dinamon e Zagrebit". Tifozët serbë nuk janë lejuar të jenë prezent në stadium dhe as ata korçarë nuk do mund të udhëtojnë në Beograd për



shkaqe sigurie, masa këto të marra pas incidenteve të ndodhura më 14 tetor të vitit 2014 në takimin Serbi-Shqipëri. Gjithsesi, Xhukiç shpreson që futbollit të fitojë dhe në fund tifozëritë të kenë mundësi të ndjekin ekipet e tyre të zemrës. "Nuk mendojmë për tension e probleme, është thjesht ndeshje futboll. Sporti bashkon dhe futbollit duhet të bashkojë rajonin. Do

të vijë koha kur nuk do të ketë më probleme mes nesh dhe tifozët do të udhëtojnë qetësisht për të parë ndeshjet në Shqipëri e Serbi". Partizani i Beogradit e kreu seancën e fundit stërvitore me kryeqytet, ndërsa deri stadiumin "Selman Stërmasi", u shoqërua nga forcat e RENEA-s, teksa ambienti rreth stadiumit ishte i blinduar nga forcat e policisë.


TRAJNERI I KUKËSIT



Milinkoviç spiunon korçarët te Partizani i Beogradit

Skuadra serbe ka gjetur mënyrën për të mësuar gjithçka duhet për rivalin që do të ketë nesër në "Elbasan Arena". 24 orë përpara zhvillimit të ndeshjes, tekniku i Partizanit të Beogradit, është takuar me trajnerin aktual të Kukësit, serbin Milinkoviç. Ky i fundit është një njohës i mirë i kampionatit shqiptar, për vetë faktin se është në Shqipëri që nga edicioni i shkuar kur ishte në drejtimin e Luftëtarit. Një kafe miqësore, por me shumë vlera për punën e tij, që do të ketë nesër kundër Skënderbeut në ndeshjen e vlefshme për takimet e treta të Europa Ligës.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Ferguson trainer.
- Grand Prix
- Eshhtë stacion beduinësh.
- Një artikull jo për vegjetarian
- Kujt i vjen... di të bëjë.
- Kaçaturian kompozitor
- Logot pa kujfj
- Parashtesë për vetë.
- Aktorja protagoniste e Vertigo.
- Ndezur në aparaturë.
- Eshhtë si telefim.
- Ai i shtatë është kinemaja.
- Eshhtë me shumë se kërkese.
- Cristiano bomber te Real Madrid.
- Teket e grave.
- Në krye të masave.
- Shkon goja... nga nepsi.
- Duken të gjata ato të pritjes.
- Gjysmë batakut.

- Eshhtë për medaljen e parë
- Eshhtë kujdesi i babait.
- 39.... Maiden që këndojnë.
- Një "bombë" tenistike.
- Fillojnë mykjen
- Janë këngëtarët si Jose Carreras
- Eshhtë këngë e kënduar nga komiku
- Lumë në Francë.
- Piktori i Ura e Narnit.
- Kapen në kujfj

VERTIKAL

- Në hyrje të ambientit
- Neeson aktor.
- Ente Sociale Rumune.
- Ajo e zezë nënkpton arbitrin.
- Kufizojnë stacionin.
- Tremb fëmijët.
- Jepet për t'u marrë.
- Qytet japonez.
- Eshhtë pemë
- Janë tallësit.
- Roberto trainer italian.
- Freni këngëtare lirike.
- Gjysmë totale.
- Një si divan.
- Tipare pa zë
- Ulet në dhomën e lartë.
- Moore aktor.
- Qe bomber brazilian.
- Ishte shpërthimi i Little Boy.
- Carolina, e bukura e Belle epoqe.
- Mbarojnë fare
- Pullman aktor.
- Eshhtë thellimi
- Meg aktore.
- Ndërmarrje Industriale Rajonale.
- Një lidhëz.
- Kaluar në krye.
- Fundi i Turandot.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Mund të hidhet te kiromanti
- Teket e kafes.
- D'Istria e Helena Gjikkës
- Smith filozof.
- Kuke regjisor
- Një pjesë e minoritetit.
- Moduli i Neil Armstrong.
- Mund të jenë qitjeje.
- Markë pistolete.
- Mbylli fushatat.
- Eshhtë dorëzim.
- Eshhtë detar.
- Fillojë ilustrimet.
- Eshhtë hon.
- Diftong në duel
- Një pjesë e rifillimit.
- Një që kuron karien.
- Nganjëherë duhen vënë mbi i.
- E egër dhe e fortë.

VERTIKAL


- E famshme ajo maqedonase.
- Një zakon.
- Bëjnë alarm me ar
- Inicialet e Mallë regjisor
- Mund të jetë telefonike
- Ka dy faqe
- Mund të jetë një cutter.
- Në mes të dhomës.
- Mbahet me bateri.
- Përfshijnë edhe Haitin.
- Denis i enëve me presion.
- Paguhen për shërbime.
- Janë ufo.
- Ekstremit në tunel.
- Një atentator vetëvrasës.
- Markë cigaresh.
- Arrihet duke mundur.
- Jonathan, regjisor i Heshnja e qengjave.
- Eshhtë aparat me zorrë.
- Pak servilizëm.
- Kështu e ka syrin vigjilenti.
- Fatih trainer turk.
- ... Nostra me mafiozët.
- Mbyllin punimet.
- Ai i shenjtë është papa.
- Kufizojnë në teknik.
- Fillojnë panikun.
- Fund tuneli.
- Në krye të armatës.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

4		9				7			5
	2	1		3		4	6		
2			1		3				9
		5				1			
3			7		5				6
	7	2		6		3	9		
1		3				8			4



Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

7	1	3	8	6	4	5	2	9	
8	4	9	3	2	5	1	7	6	
6	2	5	7	1	9	8	3	4	
1	8	4	2	7	3	9	6	5	
5	9	7	1	4	6	2	8	3	
2	3	6	9	5	8	7	4	1	
9	7	8	6	3	1	4	5	2	
4	6	1	5	8	2	3	9	7	
3	5	2	4	9	7	6	1	8	

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm



PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

H	E	S	A	P	E	T	T	P	A	B	C	
E	M	I	R	A	T	E	A	R	A	B	E	T
L	I	K	E	R	B	E	T	O	N	E	T	
E	L	S	A	D	R	I	V	A	L	E	T	
N	R	B	U	R	I	N	E	T	J	A		
M	A	R	O	K	E	N	E	O	D	A	T	
F	U	L	L	A	N	I	E	M	E	A		
P	L	A	A	T	O	M	I	K	E	A		
A	N	S	T	E	R	E	O	L	I	A		
P	A	R	S	D	M	A	R	I	A			
A	N	A	N	I	A	P	R	E	S	T	O	N
S	A	R	D	O	U	D	E	T	I	T	A	
P	A	R	A	G	R	A	F	I	V	A		
I	R	O	N	I	A	O	S	E	R	A		
R	A	B	A	T	B	A	N	A	R	A		
A	M	E	T	I	A	N	V	R	I	M	A	
T	I	R	T	E	L	E	M	A	K	U	L	
S	P	O	L	E	M	I	K	A	E	L		
V	L	A	N	A	R	I	N	A	E	N	A	
A	L	V	A	T	I	K	A	N	I	E	N	
J	O	E	T	I	N	E	T	E	M	A		
R	I	M	A	R	A	D	E	T	T	A		
A	R	T	A	N	A	A	R	U	N	I	K	
T	A	L	E	N	T	M	A	U	R	T	C	E

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

Argëtim filozofik

- Ka dy lloj njerëzish në këtë botë: Ata që kanë diçka për të thënë, dhe ata që mbarojnë për të thënë diçka...
- "Fjalët e mira janë të shkurtëra dhe të lehta për t'u thënë, por jehona e tyre është vërtet e pafundme" – **Nënë Tereza**
- Ka diferencë të madhe midis pëlgjimit dhe dashurisë.. Nëse të pëlqen një lule e këput menjëherë, ndërsa kur e do e 'ujit' dhe përkujdesesh për të gjithmonë... **Populli**

Thënie të mençura

- Vlera e një njeriu duhet parë në faktin se çfarë jep, dhe jo në atë se çfarë është në gjendje të marrë. **(Albert Ajnshtajn)**
- I dua njerëzit që kanë mbetur në jetën time, ma bënë jetën të mrekullueshme, i falënderoj edhe njerëzit që u larguan nga jeta ime, ma bënë jetën fantastike...
- A s'e sheh që luani rri i heshtur, por nga ai të gjithë janë të frikësuar, e qeni leh pa ndale por prapë është i qortohuar. **Imam Shafiu**
- Siç nuk mund të qortohet veprimi i pavetëdijshëm, kështu nuk mund të lëvdohet as mirëbërësia e detyruar. **Euripidi**

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

